

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6960  
E premte, 4 gusht 2023  
Çmimi 0.40

Sot pritet të tërhiqet  
edhe 25 për qind  
e policisë nga veriu  
i Kosovës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

OPOZITA AKTIVIZOHET PAS RAPORTIMEVE PËR KEQPËRDORIMIN  
E REZERVAVE SHETËTËRORE | FAQE 4-5

## PARALAJMËROHET HETIM PARLAMENTAR PËR REZERVAT SHETËTËRORE

- Opozita paralajmëron themelimin e një komisioni  
hetimor parlamentar për dyshimet e keqpërdorimit të  
rezervave shtetërore



Partitë opozitare janë aktivizuar pas raportimeve në medie për dyshimet e keqpërdorimit të rezervave shtetërore nga MINT-i. Përfaqësuesit e PDK-së dhe të LDK-së kanë paralajmëruar themelimin e një komisioni hetimor parlamentar për ta nxjerrë në pah të vërtetën për rezervat shtetërore.

Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka bërë me dije për "Epokën e re" se nëse qeveria Kurti nuk jep llogari për këtë çështje, do të iniciojnë themelimin e komisionit hetimor parlamentar. Në këtë kontekst, Shala ka kërkuar shkarkimin e ministres së MINT-it, Rozeta Hajdari. Ndërsa shefi i grupit

parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka deklaruar se kërkesën për themelimin e komisionit hetimor për këtë temë do ta bëjnë sapo ta nisë punën Kuvendi. Në anën tjetër, shefi i deputetëve të AAK-së, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se e mbështetin themelimin e një komisioni të tillë

NEVENKA  
TROMP:  
GJYKATA  
SPECIALE,  
LARG NJË  
INSTITUCIONI  
JURIDIK  
EFIKAS | FAQE 3



KUSHTETUESJA RRËZON DISA NENE  
TË LIGJIT PËR ZYRTARËT PUBLIKË, | FAQE 3



RENOVA  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fac: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
PRINCESHA  
GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

Bunjamini  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



KOSOVA - DANIMARKA, BILETA E  
FUNDIT DREJT KUALIFIKIMEVE PËR  
'EUROBASKET 2025' | F. 10

Kolegji  
BIZNESI  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

INFINITY  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Pas 18 vjetësh martesë, kryeministri kanadez ndahet nga gruaja

OTAVA, 3 GUSHT - Kryeministri i Kanadasë, Justin Trudeau dhe gruaja e tij Sophie po ndahen pas 18 vjetësh martesë. Çifti ka thënë se do të mbeten "një familje ku do të ketë dashuri dhe respekt të thellë". Ata janë martuar në Montreal në vitin 2005 dhe kanë tre fëmijë së bashku.

Në një deklaratë, zyra e Trudeaus ka theksuar se ndërsa çifti kishte nënshkruar marrëveshjen e ndarjes, ata do të vazhdojnë të dalin publikisht. "Ata kanë punuar për të siguruar që të gjithë hapat ligjorë dhe etikë në lidhje me vendimin e tyre për t'u ndarë janë marrë dhe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë duke ecur përpara" është thënë në deklaratë, duke shtuar se ata do të jenë me pushime si familje javën e ardhshme.

Çifti ka kërkuar privatësi për "mirëqenien" e fëmijëve të tyre, Xavier, 15 vjeç, Ella-Grace 14 dhe Hadrien, 9 vjeç. "Ne mbetemi

një familje me dashuri dhe respekt të thellë për njëri-tjetrin dhe për gjithçka që kemi ndërtuar dhe do të vazhdojmë të ndërtojmë", kanë thënë Trudeau, 51 vjeç dhe Sophie Gregoire Trudeau, 48 vjeç.

Ata janë parë së bashku publikisht më rrallë vitet e fundit, megjithëse kanë marrë pjesë në kurorëzimin e mbretit Charles III së bashku në maj dhe kanë pritur presidentin e ShBA-së, Joe Biden, në Kanada, në mars.

Në një postim të përvjetorit të martesës në "Instagram" në maj 2022, Gregoire-Trudeau kishte shkruar për sfidat e marrëdhënieve afatgjata, duke thënë se "ne kemi lundruar nëpër ditë me diell, stuhi të forta dhe gjithçka në mes".

Trudeau ka folur edhe për sfidat në martesën e tyre, duke shkruar në autobiografinë e tij të vitit 2014: "Martesa jonë nuk është perfekte dhe kemi pasur ulje-



ngritje të vështira, megjithatë Sophie mbetet shoqja ime më e mirë, partnerja ime, dashuria ime. Ne jemi të sinqertë me njëri-tjetrin, edhe kur të dhemb". Të dy kishin filluar të takoheshin në vitin 2003, kur Gregoire-

Trudeau punonte si një personazh televiziv. Ajo është e njohur për punën e saj bamirëse rreth shëndetit mendor dhe çrregullimeve të të ngrënit.

Trudeau është kryeministri i dytë kanadez që ka njoftuar ndarjen

gjatë kohës që është në detyrë. I pari ishte babai i tij, i ndjeri Pierre Elliott Trudeau dhe nëna Margaret Trudeau, të cilët kishin njoftuar ndarjen e tyre më 1977 pas gjashtë vjetësh së bashku. Më vonë ata ishin divorcuar.

## Rusia e shton Norvegjinë në listën e shteteve jomiqësore



MOSKË, 3 GUSHT - Rusia e ka shtuar Norvegjinë në listën e "shteteve jomiqësore", duke pretenduar se ky shtet po i shënjestron diplomatët rusë jashtë shtetit. Një hap i tillë i përkeqëson edhe më shumë marrëdhëniet e Rosisë me Perëndimin.

Qeveria ruse e ka publikuar urdhrin të enjten, përmes të cilit e kufizon në 27 numrin e stafit lokal që mund ta angazhojë misioni diplomatik norvegjez në Rusi.

Në muajin prill Norvegjia i ka

dëbuar 15 diplomatë rusë, duke i akuzuar për kryerje të aktiviteteve të inteligjencës nën mbulesë diplomatike.

Rusia është hakmarrë, duke i dëbuar 10 diplomatë norvegjezë, dhe ky hap për Norvegjinë ka qenë "akt i hakmarrjes".

Ministria e Jashtme e Norvegjisë ka thënë se ende nuk ka marrë informacion zyrtar nga autoritetet ruse, por që nuk ka bazë në deklarinimin se Norvegjia është jomiqësore kundrejt Rosisë. "Situata e sotshme është shkaktuar nga lufta e Rosisë në

Ukrainë. Vetë Rusia mund të zgjedhë t'i japë fund luftës", ka thënë ministrja e Jashtme norvegjeze, Anniken Huitfeldt.

Ajo ka shtuar se dy kombet, të cilat e ndajnë kufirin në Arktik, kanë interes për funksionim të marrëdhënieve diplomatike.

Shtetet e Bashkuara dhe Republika Çeke janë shtuar në listën e vendeve jomiqësore ndaj Rosisë, në maj të vitit 2021, ndërsa Greqia, Danimarka, Sllovenia, Kroacia dhe Sllovakia, janë shtuar në korrik të vitit 2022.

## Papa takohet me viktimat e abuzimit seksual nga klerikët

LISBONË, 3 GUSHT - Papa Françesku e ka mbajtur një takim privat me viktimat e abuzimit seksual nga klerikët fetarë në kuadër të një vizite pesëditore në Portugali.

Përmes një deklaratë, Vatikani ka thënë se takimi është mbajtur të mërkurën.

Një raport i vitit të kaluar ka treguar se të paktën 4 815 fëmijë janë abuzuar në Portugali dhe se Kisha ka tentuar "sistematikisht" që ta fshehtë rastin.

Në një meshë të mbajtur në mbrëmje në Lisbonë, Papa ka thënë se Kisha duhet ta dëgjojë

"vajin e viktimave".

Ai ka shtuar se skandali na drejton kah "pastrimi i vazhdueshëm", dhe se rritja e zemërimit ka kontribuar në shkëputje më të madhe të praktikimit të fesë.

Në takimin që është mbajtur te misioni diplomatik i Selisë së Shenjtë në Portugali, kanë marrë pjesë 13 viktimat e abuzimit.

Në muajin shkurt, një komision i pavarur, i krijuar nga Kisha Katolike në Portugali, e ka publikuar raportin që tregon për përvojat e 564 personave, që kanë thënë se janë abuzuar nga

priftërinjtë apo zyrtarë tjerë të Kishës.

Ky komision – i ngjashëm me komisionet e auditimit që ekzistojnë në Evropë dhe Amerikë – i ka analizuar rastet që datojnë prej vitit 1950.

Në shumë raste dëshmitarët kanë folur edhe për të mitur të tjerë të abuzuar, duke e çuar në mijëra shifrën totale.

Teksa i ka prezantuar gjetjet, psikiatri i fëmijëve, Pedro Strecht, ka thënë se vlerësimi përfaqëson "minimumin absolut" të rasteve dhe se shifrat janë vetëm "maja e ajsgbergut".





## Kushtetuesja rrëzon disa nene të Ligjit për Zyrtarët Publikë

PRISHTINË, 3 GUSHT - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka bërë me dije se ka rrëzuar disa nene të Ligjit për Zyrtarët Publikë të cilin e kishte dërguar për shqyrtim opozita. Përmes një njoftimi për medie, Kushtetuesja ka bërë me dije se ka pranuar kërkesat e partive opozitare në lidhje me këtë ligj. Gjykata Kushtetuese ka treguar se anëtarët e kësaj gjykate kanë vendosur se ligji nuk është në përputhje me disa nene të Kushtetutës. Sipas njoftimit, ligji mund të dekretohet nga presidentja pas ndryshimit të këtyre neneve. “Në lidhje me përmbajtjen e ligjit të kontestuar, gjykata njëzëri ka vendosur që (i) kriteri i ‘përshtatshmërisë’ i përcaktuar në paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtarëve/publik) të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (ii) formulimi ‘si dhe mbikëqyrë implementimin e tyre’ i pikës 1.1 të paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i nenit 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës) dhe nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 dhe paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 13 (Ministria përgjegjëse për administratë publike) të ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës; (iii) formulimi ‘në rastet e parapara sipas këtij ligji’ i paragrafit 3 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien

e punës dhe e drejta e ankesës) të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; (iv) paragrafi 6 i nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe paragrafët 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunës/it të shërbimit publik) të ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; (v) paragrafi 6 i nenit 67 (Lista e pritisjes) të ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (vi) paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (vii) paragrafi 2 i nenit 104 (Shfuqizimi) të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; ndërsa (viii) me shtatë (7) vota për dhe një (1) kundër që neni 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat



e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] dhe nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës”, është thënë në njoftimin e Kushtetueses. Gjithashtu, në aktgjykimin e Kushtetueses flitet edhe për reformën në administratë publike, e cila ishte edhe një nga vërejtjet e BE-së për ligjin e kontestuar. Specifikisht flitet për pozitat e përhershme të cilat me ligjin e kontestuar u shndërruan në pozita të përkohshme, duke afektuar zyrtarë tashmë të punësuar. “Aktgjykimi gjithashtu sqaron që bazuar në shkresat e dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesit e kërkesës, rezultoi që opinioni i zyrës ligjore të Bashkimit Evropian dhe SIGMA-s, ndër tjerash, kishte tërhequr vërejtjen për mangësitë e reformës së administratës publike. Për më tepër, bazuar në kontributet e dorëzuara në gjykatë përmes Forumit të Komisionit të Venecias, rezultoi

që përderisa administratat publike të shteteve respektive, përfshirë, përcaktojnë pozita me mandate të kufizuara, në parim, asnjë prej tyre nuk ka ndërmanë një reformë sipas të cilës pozitat me mandate të përhershme janë shndërruar në të përkohshme, duke afektuar edhe të drejtat e fituara të zyrtarëve të administratave respektive shtetërore”, është thënë në njoftim.

Më tutje është bërë me dije se edhe kriteri i “përshtatshmërisë”, i vendosur në këtë ligj, është i papajtueshëm me Kushtetutën sepse, sipas Kushtetueses, do t’i lejonte autoritetit publik një gamë të gjerë vlerësimi në pranim të punës.

Gjykata ka vlerësuar që përcaktimi i kriterit të “përshtatshmërisë” është i papajtueshëm me garantitë kushtetuese sipas sqarimeve të dhëna në dispozitivin e aktgjykimin.

Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e kanë mirëpritur

vendimin e Gjykatës Kushtetuese e cila ka shpallur disa nene antikushtetuese të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se vendimi i Kushtetueses ka dëshmuar se angazhimi i tyre për rendin kushtetues dhe vlerat demokratike është i domosdoshëm. “Kjo është edhe një dëshmi se angazhimi ynë për mbrojtjen e rëndit kushtetues dhe vlerave demokratike jo vetëm se është i vlefshëm por edhe i domosdoshëm. Ky aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese, për të shtatën herë më radhë konfirmon veprimtarinë dhe aktivitetin antikushtetues të kësaj qeverie dhe paraqet në të njëjtën kohë, goditje të drejtpërdrejtë të tendencave dhe përpjekjeve të pushtetit autokratik të Albin Kurtit për të kapur dhe nënshtruar administratën shtetërore dhe të njëjtën ta kthejë në çerdhe të militanteve, familjarëve dhe partisë së tij. Kjo është fitore e radhës e demokracisë dhe ju dedikohet të gjithë qytetarëve tanë”, ka shkruar Tahiri në “Facebook”.

Ndërsa Arben Gashi, shefi i grupit parlamentar i LDK-së, ka thënë se pushteti e mori edhe një “karton të kuq” nga Kushtetuesja.

Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se sikur Kosova të ishte anëtare e BE-së, kjo qeveri do të ishte lidere evropiane, sipas tij, në shkeljet e kushtetutshmërisë, rendit dhe ligjit, si dhe të drejtave të njeriut. PDK-ja dhe LDK-ja e kishin dërguar në Kushtetuese Ligjin për Zyrtarët Publikë.

## Sot pritet të tërhiqet edhe 25 për qind e policisë nga veriu i Kosovës



PRISHTINË, 3 GUSHT - Policia e Kosovës ka bërë me dije se sot (e premte) do ta zvogëlojë për 25 për qind praninë në dhe rreth objekteve komunale në veri të Kosovës.

Policia e ka marrë një hap të tillë edhe në korrik, në kuadër të marrëveshjes së arritur në mes të

Kosovës dhe Bashkimit Evropian për shtensionim të situatës në atë pjesë të vendit.

Përmes një komunikate për media, policia ka thënë se vendimi është marrë pas vlerësimit të situatës së sigurisë me misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR-it dhe misionin e

Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX).

Situata në veri është tensionuar në fund të majit pasi serbët lokalë e kanë kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në komunat veriore - Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Ata nuk i kanë pranuar kryetarët,

ndonëse i kanë bojkotuar zgjedhjet. Për disa javë para ndërtesave janë mbajtur protesta çdo ditë, me kërkesë që kryetarët të tërhiqen, bashkë me pjesëtarët e Policisë së Kosovës të angazhuar në atë zonë. Një tjetër pikë e marrëveshjes parasheh edhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja në

veri. Mirëpo, së fundi, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se zgjedhje nuk mund të ketë pa shtensionim të plotë të situatës në veri. “Në do të sigurohemi që kjo përvojë e re që do ta kemi me ndërprerjen e mandatit të këtyre kryetarëve në veri, të ketë mbështetjen dhe garantitë ligjore dhe procedurale. Pra, duhet të sigurohemi që procesi i tillë të jetë aq e sigurt saqë të jetë e pasfidueshëm në kuptimin legal dhe juridik”, ka thënë Kurti në një konferencë për medie.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka thënë se zgjedhjet e parakohshme mund të zhvillohen nëse 20 për qind e votuesve në një komunë nënshkruajnë një peticion për largimin e kryetarit të asaj komune. Ky peticion, sipas Krasniqit, do të dërgohej në Komisionin Qendror Zgjedhjeve (KQZ), që do ta verifikonte atë, dhe më pas do të niste një referendum me pyetjen se a duhet të shkarkohet kryetari.





OPOZITA AKTIVIZOHET PAS RAPORTIMEVE PËR KEQPËRDORIMIN E REZERVAVE SHTETËRORE

# Paralajmërohet hetim parlamentar për rezervat shtetërore

- Opozita paralajmëron themelimin e një komisioni hetimor parlamentar për dyshimet e keqpërdorimit të rezervave shtetërore

Partitë opozitare janë aktivizuar pas raportimeve në medie për dyshimet e keqpërdorimit të rezervave shtetërore nga MINT-i. Përfaqësuesit e PDK-së dhe të LDK-së kanë paralajmëruar themelimin e një komisioni hetimor parlamentar për ta nxjerrë në pah të vërtetën për rezervat shtetërore. Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka bërë me dije për “Epokën e re” se nëse qeveria Kurti nuk jep llogari për këtë çështje, do të iniciojnë themelimin e komisionit hetimor parlamentar. Në këtë kontekst, Shala ka kërkuar shkarkimin e ministres së MINT-it, Rozeta Hajdari. Ndërsa shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka deklaruar se kërkesën për themelimin e komisionit hetimor për këtë temë do ta bëjnë sapo ta nisë punën Kuvendi. Në anën tjetër, shefi i deputetëve të AAK-së, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se e mbështetin themelimin e një komisioni të tillë

**EPOKA  
ERE**

**Lirim GECI**

PRISHTINË, 3 GUSHT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) janë aktivizuar pas raportimeve në medie rreth skandalit të vajit dhe grurit nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë (MINT). Zyrtarët e këtyre dy partive opozitare kanë paralajmëruar se në muajin shtator do ta iniciojnë themelimin e një komisioni hetimor parlamentar për të hedhur dritë rreth dyshimeve për keqpërdorimin e rezervave shtetërore. Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka bërë me dije se do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore parlamentare për t'i sqaruar dyshimet për keqpërdorimin e rezervave shtetërore nga MINT-i. Shala, i cili është edhe kryetar i

Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, ka thënë për “Epokën e re” se nëse qeveria nuk ndërmerr veprime për t'i sqaruar dyshimet për aferën e vajit dhe grurit, atëherë si parti parlamentare do ta kërkojnë themelimin e komisionit hetimor parlamentar për rezervat shtetërore. “Definitivisht jemi të gatshëm sepse ne kemi pasur praktika të tilla kur qeveria ka insistuar t'i ikë llogaridhënies edhe tek aferat e energjisë, por me insistimin e partive opozitare ne kemi arritur t'i krijojmë komisionet hetimore parlamentare dhe sot, si rezultat i atyre komisioneve, kemi veprime konkrete juridike të institucioneve të tjera shtetërore. Dhe nëse deri në vjeshtë nuk kemi veprim juridik dhe nëse nuk kemi sqarime nga mazhoranca, gjegjësisht nga qeveria dhe llogaridhënie, atëherë domosdoshmërisht do ta përdorim edhe mekanizmin e

fundit që është komisioni hetimor parlamentar. Por, i bëj thirrje kryeministrit dhe qeverisë që për të mos e prishur normalitetin e funksionimit të Kuvendit në vjeshtë, ai (Albin Kurti) urgjentisht do të duhej të marrë masa, ta sqarojë para opinionit çështjen e rezervës shtetërore konform përgjegjësive që ka qeveria dhe secili aktor qeveritar”, ka thënë Shala. Shala ka theksuar se shqetësimet për rezervat e vajit dhe grurit i kanë ngritur në Kuvendin e Kosovës tash e një vit. “Grupi parlamentar i PDK-së i ka ngritur këto shqetësime më shumë se një vjet, veçanërisht për rezervat e miellit dhe vajit. Kemi pasur debate, pyetje parlamentare dhe shqetësime për këtë tema. Në kuadër të kësaj kemi pasur edhe një debat parlamentar në Kuvendin e Kosovës ku i kemi shpërfaqur të gjitha dyshimet tona, tashmë të bazuara për keqpërdorime të skajshme sa iu

përket rezervave shtetërore, veçanërisht të produkteve të vajit dhe grurit, por edhe të produkteve të tjera. Në këtë relacion, qeveria, gjegjësisht ministria dhe kryeministri, i kanë ikur realitetit, përgjegjësive dhe llogaridhënies, duke e mbuluar këtë aferë dhe këtë keqpërdorim të skajshëm, duke i vendosur siglën ‘sekret shtetëror’ dhe duke mbyllur çdo informacion për qytetarët, për vendin dhe për parlamentarët çka është më e keqja. Në këtë relacion, përkundër vështirësive të mëdha për të ardhur deri tek informacionet, tashmë janë publike ku edhe mediet kanë konstatuar që sot kemi skandalet më të mëdha korruptive që kanë ndodhur në këtë qeveri me rezervat shtetërore e ku parashihet se do të jenë të implikuar jo vetëm ministra dhe zëvendësministra por, ndoshta, edhe nivele të larta të kabinetit të kryeministrit”, është shprehur Shala. Në këtë kontekst, Shala ka kërkuar dorëheqjen e ministres së MINT-it, Rozeta Hajdari. “Kjo ministre duhet ta lirojë detyrën. Fatkeqësisht ajo është mbrojtur me fanatizëm të paparë dhe në mënyrë të paarsyeshme nga kryeministri sepse, si duket, është jashtëzakonisht problematike çështja e aferave qoftë të energjisë apo rezervave shtetërore sepse kryeministri është në dijeni për to ose për mos të thënë i involvuar direkt”, është shprehur Shala, duke shprehur se

askush nuk do të mund ta ndalë të dalë në pah e vërteta për rezervat shtetërore. “Asgjë nuk mund ta ndalë të vërtetën. Ne si parti parlamentare dhe opozitare do të bëjmë çdo gjë që është e mundur që brenda kuadrit legjislativ, Rregullores së Kuvendit që në sesionin vjeshtor ta aktualizojmë këtë temë dhe ta zbardhim qoftë edhe me komisione hetimore parlamentare apo me sesione të tjera të debatit”, është shprehur Shala. Më tutje, Shala ka thënë se historia e Kosovës nuk njehe qeveri më të korruptuar se kjo e tanishmja që drejtohet nga Albin Kurti. Nëse e marrim parasysh aspektin kohor të qeverisjes dyvjeçare dhe i marrim parametrat të cilët janë të njohur deri më tani dhe shumë të panjohura, flas për afera korruptive nga sektori i energjisë, nga sektori i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ai i infrastrukturës që tashmë aferat korruptive janë të dukshme dhe të matshme në pjesë dhe segmente të caktuara si dhe aferën e fundit për rezervën shtetërore, nuk ka qeveri për kaq kohë të shkurtër që ka pasur afera korruptive dhe kaq shumë skandale të niveleve menaxhuese. Në këtë relacion ne nuk e kemi asnjë parametër zhvillimor. Ne sot e kemi shkallën më të ulët të realizimit të projekteve nëse e marrim dhe e krahasojmë me periudhën kohore, por edhe me buxhetin



## Gjykata Komerciale vendos në favor të "Klan Kosovës"

PRISHTINË, 3 GUSHT - Gjykata Komerciale e Kosovës ka marrë vendim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit qeveritar për pezullimin e certifikatës së biznesit të televizionit "Klan Kosova".

Në vendimin e Komerciales është thënë se ekzekutimi i vendimit shtyhet deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata për këtë rast.

Më 28 korrik Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) e ka konfirmuar pezullimin e licencës së biznesit të "Klan Kosovës". Ajo e ka rikonfirmuar një vendim të 14 qershorit që ia pezullon licencën këtij biznesi me "pretendimin se në certifikatën e biznesit, te ndërimi i pronarëve, figuron Pejë - Serbia dhe Gjakovë - Serbia" dhe diçka e tillë shkel Kushtetutën e Kosovës.

"Klan Kosova" e ka kundërshtuar këtë vendim dhe e ka paditur MINT-in. Juristja e medieve në Kosovë, Flutura Kusari, e ka konsideruar vendimin e 2 gushtit si fitore të parë. Sipas saj, vendimi i jep hapësirë Klan Kosovës që ta vazhdojë punën lirshëm në 2-3 vjetet e ardhshëm. "Vendimi i sotëm gjyqësor - ndonëse i

përkohshëm - është indikator shumë i fuqishëm që tentativa e qeverisë për të mbyllur Klan Kosova është e kundërligjshme, arbitrare, joproporcionale dhe me rrezik të madh për pluralizmin e medieve", ka thënë ajo.

Edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) e ka mirëpritur vendimin e gjykatës. "AGK-ja do t'i monitorojë nga afër procedurat e tjera në vazhdim, me shpresën që epilogu i shpejtë do të përmballë këtë episod të përpjekjes së qeverisë për të minuar lirinë e medias në Kosovë", është thënë në reagimin e AGK-së

### Vendimi i gjykatës

Në vendimin e marrë më 2 gusht Gjykata Komerciale ka thënë se e ka miratuar kërkesën e "Klan Kosovës" pasi ky biznes e ka "argumentuar faktin se ekzekutimi i vendimeve do t'i sillte dëm, i cili vështirë do të riparohej, si dhe ka argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik".

"Klan Kosova" ka thënë se i ka rreth 220 të punësuar dhe qindra



kontraktorë komerciale.

Në vendim gjykata ka thënë se "Klan Kosova" i ka bërë edhe përmirësimet e nevojshme për regjistrim të biznesit. "Sipas certifikatës së regjistrimit nr. ser. 10076953 dhe informatat e biznesit të lëshuara me datë 21.06.2023, 'Klan Kosova' Sh.PK. është shoqëri tregtare e regjistruar në Kosovë me datë 26.11.2008, me numër unik identifikues 810795297 me seli në Zonën Industriale, ish-Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë", është

thënë vendimin e Komerciales. Gjykata Komerciale e ka vendosur një afat ankese ndaj këtij vendimi brenda 15 ditësh.

### Reagimet për vendimin e MINT-it

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe pjesëtarë të shoqërisë civile kanë protestuar më 31 korrik në Prishtinë kundër, siç kanë thënë, "kontrollit të qeverisë ndaj

medieve". Të shqetësuar për këtë rast janë shprehur vendet e Quintit: Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Gjermania dhe Franca. Në komunikatën e përbashkët ambasadorët e këtyre vendeve kanë thënë se presin proces ligjor "të drejtë dhe transparent për zgjidhjen e kësaj çështjeje". Po ashtu, edhe opozita është shprehur e shqetësuar lidhur me këtë veprim të qeverisë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë më 29 qershor se zbatim i ligjit kundër biznesmenëve që e shkelin atë për përfitime financiare nuk nënkupton sulm ndaj lirisë së medieve. "Kosova i ka 468 biznese të regjistruara, aktiviteti kryesor i të cilave është media, dhe 114 kompani të licencuara audio-vizuale. Zbatimi i rregullave të regjistrimit është detyrë ligjore, jo teknikalitet". Dhe zbatimi i rregullave të tilla kundër një shkelësi të vetëm nuk e kërcënon pluralizmin medial", kishte thënë Kurti.

"Klan Kosova", televizion privat me seli në Prishtinë, e ka nisur transmetimin më 17 shkurt të vitit 2009.

## Çitaku fton organet e rendit që urgjentisht t'i hetojnë aferat e qeverisë Kurti

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Nën kryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, i ka bërë thirrje Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë të bëjnë hetime rreth raportimeve ku zyrtarë të qeverisë Kurti po akuzohen për afere korruptive.

Në një konferencë për medie, ajo ka thënë se është e pakuptueshme heshtja e qeverisë dhe kryeministrit Albin Kurti ndaj këtyre akuzave. "Siç e keni parë gjatë kësaj kohe, çdo ditë po pasurohet albumi i korrupsionit të kësaj qeverie. Raportimet e medieve po tregojnë që eksponentë të partisë-shtet nuk kanë lënë asnjë sektor pa shtrirë rrjetin e korrupsionit, përfshirë edhe në gjërat më esenciale: rrymë, grurë e vaj. Dje pamë edhe raportimet për abuzim të fondeve që janë të parapara për komunitete dhe rastësisht na doli që personat që kanë përfituar, të jenë familjarë të ministrave të kësaj qeverie. Shumë prej tyre nuk e kishin as idenë më të vogël se për çka kanë përfituar ato fonde.



Përballë krejt kësaj situatë, më skandaloze se aferat, kanë qenë reagimet e kryeministrit Kurti dhe eksponentëve të qeverisë. Në rastin më të mirë ka pasur indiferencë dhe shpërfillje derisa, në rastin më të keq, ka pasur një mbrojtje të pashpjegueshme të aktorëve të përfshirë në korrupsion dhe një sulm histerik kundër prokurorisë dhe medieve.

Ftojme institucionet e rendit, policinë dhe prokurorinë, që urgjentisht të hetojnë të gjitha aferat e kësaj qeverie dhe të mos lejojnë prishjen dhe humbjen e provave: sikur që kanë humbur vajin dhe grurin!", ka thënë ajo.

Sipas saj, qeveria Kurti nuk i ka shpallur luftë korrupsionit, por gazetarëve të cilët, sipas saj, po i zbulojnë rastet korruptive.

"Ambasadori Martin Berishaj vazhdon të jetë në detyrë, përkundër fakteve të shpalosura të cilat e lidhin me shpërdorimin e miliona eurove. Nagip Krasniqi, i dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, mik i Kryeministrit Kurti, përkundër arrestimit të tij ai është vetëm i pezulluar nga detyra, por jo edhe i përjashtuar. Rozeta Hajdari, e cila ka blerë grurë prej kompanive të ndërtimit, e gruri nuk ka ardhur asnjëherë në Kosovë, vazhdon të mbetet në detyrë. Pesë ministra, zëvendësministra e shumë zyrtarë të tjerë, në shumë institucione, sot janë nën hetime nga Task-Forca Anti-Korrupsion në Policinë e Kosovës. Asnjë llogaridhënie deri më tash, përkundrazi, kjo qeveri nuk i ka shpallur luftë korrupsionit, por gazetarëve, të cilët po e zbulojnë korrupsionin dhe rendit e ligjit, të cilët po e hetojnë atë", ka thënë Çitaku.

Më tutje, Çitaku ka thënë se audio-incizimet e publikuara në medie kanë shpërfaqur, siç ka theksuar ajo, presionin e madh që po i bëhet

administratës publike dhe shërbyesve civilë nga zyrtarët shtetërorë për ta shkelur ligjin. "Çdo ditë e më shumë, po rrënohet aura e epërsisë morale, të cilën LV-ja ia kishte mveshur vetes, si parti me duar të pastra. Faktet po tregojnë që këto kanë qenë vetëm fraza boshe. Audio-incizimet po tregojnë edhe për presionin e madh që po u bëhet administratës publike dhe shërbyesve civilë, jo për ta respektuar ligjin, por për ta shkelur atë. Derisa aferat po shtohen, keqpërdorimet e detyrës zyrtare po prekin të gjitha institucionet e kësaj qeverie, fatkeqësisht, janë qytetarët të cilët po i vuajnë pasojat. Rritja e çmimeve, papunësia dhe varfëria, janë tri problemet me të mëdha me të cilat po ballafaqohen qytetarët tanë sot! Në vend të zgjidhjeve, kjo qeveri ka ofruar vetëm cikle të pafundme të krizave dhe skandaleve. Edhe një herë, po e ripërsëris thirrjen për institucionet e hetuesisë dhe drejtësisë që të veprojnë", ka thënë Çitaku.

sepse gjithmonë shkalla e realizimit të investimeve kapitale matet se sa ka qenë i planifikuar buxheti. Pra kemi një buxhet jashtëzakonisht të lartë dhe kemi një shkallë shumë të ulët të realizimit të investimeve kapitale. Në këtë fushë nuk kemi sot asnjë parametër ekonomik që mund ta arsyetonte apo vlerësonte pozitivisht funksionimin e kësaj qeverie", është shprehur Shala.

### Gashi thotë se themelimi i komisionit hetimor është i domosdoshëm

Edhe shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka kërkuar hetim parlamentar për rastin e skandalit të vajit dhe grurit. Gashi ka thënë se kërkesën për themelimin e komisionit hetimor për këtë

temë do ta bëjnë sapo ta nisë punën Kuvendi i Kosovës. "Keqpërdorimet dhe abuzimet eventuale me rezerva shtetërore, përkatësisht me produkte esenciale, kërkojnë qasje hetimore serioze dhe përmbytësore. Në këtë kontekst, LDK-ja me fillimin e sesionit vjeshtor do të kërkojë që të formohet një komision hetimor parlamentar për t'i hetuar keqpërdorimet dhe

abuzimet e mundshme me rezervat shtetërore. Kështu që, përveç hetimeve penale që duhet t'i bëjë Prokuroria e Shtetit për këto raste, ne konsiderojmë se është e domosdoshme të kemi edhe hetim parlamentar për të parë nga afër se sa janë respektuar ligjet dhe procedurat për çështjen e rezervave shtetërore", ka shkruar Gashi në "Facebook". Themelimin e një komisioni të

tillë e ka mbështetur edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri. Ai ka thënë shkurt për "Epokën e re" se do ta mbështetin themelimin e komisionit hetimor parlamentar. "Po, e mbështetim", ka thënë Tahiri. Gazeta "Nacionale" ka publikuar disa audio-incizime ku shfaqen dyshimet për keqpërdorimin e rezervave shtetërore.



# Nevenka Tromp: Gjykata Speciale, larg një institucioni juridik efikas

PRISHTINE, 3 GUSHT - Gjykata Speciale është larg nga një institucion juridik efikas. Kështu ka thënë Nevenka Tromp, e cila ka punuar për shumë vjet në Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavi. Ajo ka theksuar se kjo gjykatë ka shumë mangësi sa i përket transparencës derisa ka shprehur shqetësim se seancat e mbyllura mund t'i nxisin dëshmitarët që të flasin çfarë të duan në gjykatore. Në tetëvjetorin e krijimit të Speciales, Trompi ka treguar nëse kishte motiv të fortë për këtë vendim, si dhe çfarë pret nga gjykimi i Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Ligjëruesja në Universitetin e Amsterdambit ka thënë se e kupton pse Kuvendi i Kosovës vendosi t'i përmbushë kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare, në veçanti të Shteteve të Bashkuara, për t'i krijuar Dhomat e Specializuara dhe t'i transferojë ato në Holandë. "Kishte një motiv politik shumë të rëndësishëm që Kuvendi i Kosovës dhe lidhshipi i Kosovës në atë kohë të pajtoheshin me Amerikën, pse? Sepse Shtetet e Bashkuara kanë qenë partneri dhe mbështetësi më i rëndësishëm i çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës. Dhe Kosova duke qenë ende një shtet de-fakto në thelb, nuk mund të ia lejojë vetes të mos ketë aleatë siç janë Shtetet e Bashkuara, pra në të vërtetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të shihen si një shtet mbrojtës i Kosovës sepse si shtet ende i pa njohur plotësisht nga OKB-ja, Kosova ka disa vështirësi për t'u angazhuar në marrëdhëniet ndërkombëtare. Pra, nga ai këndvështrim, ka shpjegime dhe arsye pse ne vëzhguesit e jashtëm mund ta shohim logjikën pse Kuvendi i Kosovës e ndërmoi këtë hap në gusht të vitit 2015. Por nëse tani shikoni se çfarë dhe si është krijuar kjo gjykatë, cilat janë rregullat e



statutit të saj për procedurën dhe efikasitetin kur është fjala për numrin e të akuzuarve, aktakuzave dhe numrin e dënimeve apo aktgjykimeve të deritanishme, atëherë shohim se është larg nga një institucion juridik efikas që merret me krimet më të rënda politike, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit", ka thënë Trompi për "Kosovapress".

Në Gjykatën Speciale deri tani janë gjashtë persona të akuzuar për krime të pretenduara të luftës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, Pjetër Shala dhe Salih Mustafa, ku ndaj këtij të fundit në dhjetor të vitit të kaluar është shqiptuar dënim fajësie në shkallë të parë me 26 vjet burgim. Trompi e ka konsideruar këtë shembull ekstrem të drejtësisë dhe, sipas saj, dënimi është shumë i lartë krahasuar me numrin e viktimave të supozuara si dhe periudhën që mbulon aktakuzën.

Krahas këtij shqetësimi, Trompi përmend edhe seancat e mbyllura që po zhvillohen në rastin e katër liderëve të UÇK-së, gjykim ky i cili ka nisur në prill të këtij viti. Deri tani në këtë çështje gjyqësore janë dëgjuar 15 dëshmitarë të thirrur nga Zyra e

Prokurorit të Specializuar dhe vetëm dy prej tyre kanë dëshmuar pa masa mbrojtëse, për dallim nga të tjerët që, përveç se ishin të mbrojtur, dëshmuar në seanca tërësisht të mbyllura për publikun. "Edhe në këtë fazë shumë të hershme të gjykimin të Thaçit dhe të tjerëve, ne shohim se gjykata po ka shumë mangësi sa i përket transparencës dhe publikimit të procedurave, për ata që realisht kujdesen për këtë, dhe kush janë ata, padyshim janë njerëz të Kosovës. Pra, këto janë çështje shumë madhore dhe pika shqetësuese kur bëhet fjalë për efikasitetin e kësaj gjykate dhe padyshim ritmin e ngadaltë të gjykimin ndaj Thaçit dhe të tjerëve për të ardhur në procedurë gjyqësore, sepse kanë qenë në paraburgim për më shumë se dy vjet. Në fakt na kthen te ky lloj, mbipërdorimi..., i cili thotë se drejtësia e ngadaltë nuk është aspak drejtësi. Nëse vërtet dëshironi që një gjykatë të lavdërohet për efikasitetin e saj, atëherë duhet të jetë një kohë e arsyeshme që nga momenti që paditë ngrihen, të akuzuarit vendosen në paraburgim, presin gjykimin dhe më pas gjykimi duhet të jetë sa më i shpejtë dhe efikas. Deri më tani nuk kemi

parë asnjë nga këto", ka thënë ajo.

Trompi, e cila ka shkruar librin "Gjykimi i papërfunduar i Millosheviqit", ka thënë se seancat e mbyllura ku trajtohen raste të këtij formati janë vrasës të sistemit ndërkombëtar të drejtësisë. Ajo ka thënë se transparenca duhet trajtuar si një nga elementet më të rëndësishme. Derisa sipas prokurorisë, seancat e mbyllura kërkohen për të mbrojtur dëshmitarët, Trompi ka thënë se në këtë mënyrë çdokush mund të dalë të flasë çka të dojë në gjykatore ndërkohë që pamundësohet të ketë masë kritikuese nga jashtë. "Në të njëjtën kohë, mund të thuash gjithashtu se kjo lloj mbyllje e provave nga pjesa e prokurorisë në të vërtetë mund të nxisë çdo lloj dëshmitari që të vijë në gjykatë dhe të thotë çfarë të dojë, sepse ai ose ajo do të ndihet i mbrojtur dhe nëse thotë gjysmë të vërtetën, nuk do kishte asnjë masë kritikuese nga jashtë që do e dëgjonte dhe do të thoshte, 'hej, ky person nuk mund të ishte atje sepse ne ishim bashkë në Shqipëri në atë kohë', që ai ose ajo tani thotë se çfarë ndodhi. Pra, nëse prokuroria përdor seancat e mbyllura deri

më tani për të thënë se duhet të mbrojmë dëshmitarët tanë, mbrojtja mund të thotë se ne kemi nevojë që këta dëshmitarë t'i thonë këto gjëra hapur, sepse ne besojmë se disa prej tyre në fakt nuk po thonë të vërtetën, dhe njerëzit që ata i njohin, njerëzit që i kaluan këto ditë dhe vite kritike së bashku në vitin 1998 apo 1999, në fakt mund të vinin tek ne dhe të thoshin 'jo nuk është e vërtetë, ky dëshmitar nuk po thotë të vërtetën' dhe kjo është arsyeja pse prokuroria është në fakt tani në një rrugë të rrëshqitshme, sepse si mund të keni përfundimisht një gjykim ku citoni dëshmitarët, deklaratat e të cilëve duhet t'i fshihni në vendimin përfundimtar, sa i besueshëm do të ishte ky gjykim, ose nëse do ekzistonte një dënim nëse askush nga bota e jashtme nuk mund të lexojë gjykimin dhe të thotë 'Po sigurisht, jam dakord me këtë', ka thënë ajo.

Madje, sipas saj, aktgjykimet e bazuara në seanca të mbyllura potencialisht dëmtojnë sistemin ndërkombëtar të drejtësisë. Gjykimi ndaj ish-kreerëve të UÇK-së i nisur në prill të këtij viti pritet të marrë goxha kohë deri në përfundim. Dy vjet janë paraparë vetëm për çështjen e ZPS e cila ka paralajmëruar qindra dëshmitarë në këtë çështje gjyqësore ku pretendohen se janë 140 viktima pjesëmarrëse. Trompi e ka vështirë ta parashikojë rrjedhën e këtij procesi meqë seancat e deritanishme ishin pothuajse tërësisht të mbyllura, por ka thënë se bazuar në aktakuzë dhe shtrirje kohore, përfundimi do të duhej të ishte me lirim nga akuzat për Thaçin dhe të tjerët. Më tutje, Trompi ka folur edhe për mungesën e aktakuzave të reja nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, derisa ka theksuar se prokuroria po ka vështirësi në trajtimin e gjashtë rasteve që aktualisht janë para kësaj gjykate.

## Kosova dëbon dy serbë për pjesëmarrje në protesta të dhunshme në veri

PRISHTINE, 3 GUSHT - Gjykata Themelore në Prishtinë i ka dënuar dy persona të nacionalitetit serb me inicialet S. J. dhe I. S., me gjashtë muaj burgim, me mundësinë e shndërrimit të dënimit në gjobë. Avokati Lubomir Pantoviq i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se paratë u janë dorëzuar autoriteteve dhe ata do të kthehen në Serbi. "Ndaj tyre është caktuar masa e dëbimit nga Kosova dhe ndalimi i hyrjes në shtet për tri vjet", ka thënë Pantoviq.

Të dy personat janë arrestuar në fund të majit në pikëkalimin kufitar të Jarinjës, ndërsa në

fund të korrikut ata janë paditur nën dyshimet për "pjesëmarrje në protesta të dhunshme" dhe "posedim të paautorizuar të armëve".

Zyra e Prokurorit në Kosovë ka thënë paraprakisht se të dy personat kanë qenë duke "përgatitur veprime për të shkaktuar rrezik të përgjithshëm" dhe ata janë në kontakt me "protestues të dhunshëm serbë", të cilët janë përlëshur me ushtarët e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, më 29 maj, para ndërtesës komunale të Zveçanit.

Në këtë konflikt janë plagosur rreth 30 ushtarë të KFOR-it dhe

dhjetëra protestues të komunitetit serb.

Policia e Kosovës i ka arrestuar deri më tani disa serbë për sulmet ndaj policisë, KFOR-it dhe gazetarëve. Megjithatë, shumica janë liruar që atëherë. Situata në veri është tensionuar në fund të majit pasi serbët lokalë e kanë kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në komunat veriore - Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Ata nuk i kanë pranuar kryetarët, ndonëse i kanë bojkotuar zgjedhjet. Për disa javë para ndërtesave janë mbajtur protesta çdo ditë, me kërkesë që kryetarët të tërhiqen, bashkë me



pjesëtarët e policisë të angazhuar në atë zonë. Më 10 korrik Kosova dhe Bashkimi Evropian kanë arritur

marrëveshje për ulje të tensioneve që, mes të tjerash, parasheh edhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja.



# Si po zhduken gjurmët e luftës?

**PRISHTINË, 3 GUSHT** - Rreth 100 metra larg varreve të dy djemve të saj, në fshatin Mejë të Gjakovës, në jugperëndim të Kosovës, guri përkujtimor i Pashkë Markajt – nënës e cila e dogji veten me benzinë në vitin 2003, katër ditë pasi i varrosi dy djemtë e saj - mbeti i përmbysur. Gjevalin dhe Milan Markaj ishin në mesin e 376 civilëve shqiptarë të vrarë nga forcat serbe në masakrën e Mejës në prillin e vitit 1999. Trupat e tyre u gjetën në varrezën masive në Batajnicë, në afërsi të Beogradit, në Serbi, në vitin 2001, bashkë me më shumë se 700 trupa të kosovarëve të vrarë nga forcat serbe gjatë luftës së viteve 1998-'99.

Në vitin 2004, një vit pasi Pashkë Markajdogji veten, familjarët, në pajtim me pronarin e një toke private në fshatin Korenicë të Gjakovës, vendosën një gur përkujtimor në vendin ku ajo u vetëflijua.

Ky gur përkujtimor qëndroi në këtë tokë deri më 21 korrik 2023, kur pronari i tokës vendosi ta largonte atë. "Asnjë shenjë nuk ka qenë aty. Vetëm guri. Është vizituar nga njerëzit që e kanë ditur historinë", thotë nipi i Pashkës, Liridon Marku, për Radion Evropa e Lirë.

Në mungesë të përkujdesjes institucionale, ky monument, që familjarët thonë se për ta përfaqëson dhimbje e mërzë, u hodh skaj rrugës, pranë një grumbulli mbeturinash, në dalje të fshatit Mejë.

Pronari i tokës ku ishte i vendosur guri – e me të cilin Radio Evropa e Lirë nuk arriti të kontaktonte – nuk i bëri publike arsyet se pse vendosi ta largonte gurin përkujtimor pas 19 vjetësh. Pasi largimi i gurit bëri bujë në media, Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve



dhe Komplekseve Memoriale në Kosovë e mori nën përkujdesje këtë monument dhe e dërgoi atë përkohësisht në kompleksin e martirëve në Mejë. Aty edhe sot guri rri i përmbysur.

## U mor në mbrojtje, por u la i përmbysur në Mejë

Derisa familja Marku mendon se guri përkujtimor i Pashkës do të "peshonte" më së miri në vendin ku ajo vrau veten, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në Kosovë tha se guri përkujtimor do të qëndrojë përkohësisht në Kompleksin Memorial "27 Prilli", në Mejë, deri në një zgjidhje të përhershme.

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, e cila vepron në kuadër të kësaj ministrie, është zotuar se "do të sigurohet që, në pajtim me ligjin, të ndërmarret të gjithë hapat e nevojshëm për ofrimin e zgjidhjes së duhur, duke ruajtur vlerat shpirtërore, historike".

## Memorialet, pa përkujdesje dhe pa informacione për vizitorët

Guri përkujtimor i Pashkë Markajt nuk është monumenti i vetëm pa përkujdesje institucionale në Kosovë. Janë edhe dhjetëra objekte dhe monumente të tjera, të lidhura me ngjarjet e luftës së viteve 1998-'99, që nuk gëzojnë kurrfarë përkujdesje. Fondi për të Drejtën Humanitare i Kosovës, në një studim të publikuar në vitin 2022, kishte identifikuar 12 vende të krimit, të cilat nuk janë të shënuara askund, dhe që janë pak të njohura për publikun.

Aty përmenden: Burgu i Smerkonics në Vushtrri, Spitali i Prishtinës, Ura e Lluzhanit, Xhamia e Krushës së Madhe, Varrezat masive, Stacioni i autobusëve, Stacioni i trenit në Fushë-Kosovë, Kufiri me Shqipërinë, si dhe disa lokacione të tjera. Asnjë nga këto vende, në të cilat janë kryer krime të luftës, si dhe në të cilat janë vrarë civilë,

kryesisht shqiptarë, nuk janë të shënuara si monumente që i takojnë trashëgimisë së luftës së fundit.

Drejtori i Fondit për të Drejtën Humanitare të Kosovës, Bekim Blakaj, thotë se shënimi dhe mbrojtja e këtyre objekteve dhe monumenteve do të ndihmonte në pasurimin dhe ruajtjen e kujtesës kolektive.

Blakaj sugjeron formimin e një komisioni profesional, që do të duhej t'i vlerësonte të gjitha memorialet që janë ngritur pas luftës. "Secili memorial që i plotëson kriteret bazike pastaj do të duhej të merrej në përkujdesje të shtetit", vlerëson Blakaj.

Profesori i Departamentit të Historisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", Durim Abdullahu, thotë se shoqëria në Kosovë jeton e rrethuar nga trashëgimia e luftës së fundit, por "duke qenë se ajo është pothuajse e kudondodhur, ka ngelur e patrajtuar".

Abdullahu e cilëson të rëndësishëm ndërtimin e mekanizmave institucionale

shtetërorë, përmes të cilëve do të mbrohej trashëgimia e luftës, pasi që, siç thotë ai, në shumë pak raste janë shënuar vendet ku kanë ndodhur vrasje e masakra gjatë luftës së viteve 1998-'99. "Shteti i Kosovës duhet të krijojë një hartë me të gjitha vendet e masakrave dhe të projektojë një program të integruar të shënimit të vendeve të masakrave dhe të luftimeve", konsideron Abdullahu.

Në shumë vende ku kanë ndodhur krime, dhe ku ka memoriale në Kosovë, nuk ka shënime adekuate për ngjarjen. Mungojnë tabela me tekst apo versione digjitale, përmes së cilave do të mund të shpjegohej historia e masakrave, viktimitave dhe vetë historia e luftës.

## Zhdukja graduale e trashëgimisë së luftës

Lufta në Kosovë zyrtarisht ka përfunduar në qershor të vitit 1999. Por, që nga kjo kohë, Kosova nuk ka krijuar një bazë të dhënash të sakta të personave të vrarë.

Bazë të dhënash nuk ka as për shtëpitë e djegura, as për vendet ku janë kryer krimet, e as për dëmet e tjera të luftës. Në muajin korrik, Kuvendi i Kosovës miratoi Projektligjin për Institutin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Përmes këtij vendimi, Kosova, për herë të parë, do të themelojë një institut të tillë, i cili ka për qëllim dokumentimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, nga 1 janari i vitit 1998 deri më 20 qershor të vitit 2000. Dokumentimin e krimeve të luftës, ky institut pritet ta bëjë nga aspekti historik, ushtarak, ekonomik, juridik, ekologjik, kulturor, mjekoligjor dhe sociologjik. Gjatë luftës në Kosovë, në periudhën 1998-'99, llogaritet se janë vrarë më shumë se 13 500 njerëz. Në tërë territorin e Kosovës llogaritet të kenë ndodhur rreth 400 masakra.

# BE-ja publikon raportin për Kosovën: Gjendja në veri sfiduese, situata në dialog e brishtë

**BRUKSEL, 3 GUSHT** - Bashkimi Evropian (BE) në raportin për të drejtat e njeriut ka thënë se situata në veri të Kosovës mbetet sfiduese, veçanërisht sa i përket gjykimin të korrupsionit, krimit të organizuar dhe kushteve për lirinë e shprehjes, përfshirë sulmet ndaj profesionistëve të medias.

Raporti ka theksuar se dorëheqja masive e serbëve të Kosovës nga institucionet publike dhe ngritja e postbllloqeve pasuese ndikuan negativisht në siguri ku, ndër të tjera, është thënë se sistemi i drejtësisë dhe policia funksionojnë me kapacitet shumë të reduktuar. "Në vitin 2022, Kosova gëzonte stabilitet politik, ku qeveria kishte një shumicë solide në Kuvend. Ky mjedis politik ka qenë i favorshëm që Kosova të shtojë përpjekjet e saj për të forcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit. Megjithatë, puna e Kuvendit vazhdoi të



ndikohet negativisht nga një atmosferë e polarizuar politike dhe mungesa e kuorumit vendimmarrës", është thënë në raportin e BE-së.

Raporti ka përmendur edhe angazhimin në dialog. Është thënë se BE-ja vazhdon ta lehtësojë dialogun për normalizimin e marrëdhënieve

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Ka pasur kriza të përsëritura në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në vitin 2022 dhe situata në terren mbetet e brishtë. Megjithatë, në vitin 2022, palët miratuan një Udhërrëfyes për Zbatimin e Marrëveshjeve të Energjisë, ranë dakord për udhëtimin vetëm me karta

identiteti dhe arritën një marrëveshje që të përmbahen nga veprimet e mëtejshme për targa për të lejuar që dialogu të fokusohet në propozimin e fundit të BE-së për normalizimin e marrëdhënieve", është thënë në raport. Po ashtu, raporti ka theksuar se procesi zgjedhor i Kosovës ka ende nevojë për

fuqizim për t'i adresuar dobësitë gjatë gjithë ciklit zgjedhor.

Raporti ka vënë në fokus se Kosova duhet të punojë më shumë për t'i zbatuar ligjet për të drejtat themelore të njeriut.

Në raportin për të drejtat e njeriut të publikuar nga BE-ja është thënë se kuadri ligjor të cilin e ka Kosova garanton mbrojtjen e të drejtave themelore dhe është në përputhje me standardet evropiane. "Ndërgjegjësimi i publikut për të drejtat e personave LGBTI mbetet i ulët. Duhet bërë më shumë për të garantuar barazinë gjinore dhe mbrojtjen e fëmijëve në praktikë. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të garantuar në mënyrë efektive të drejtat e personave që u përkasin pakicave, duke përfshirë romët, ashkallitë dhe egiptianët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e zhvendosur", është thënë në raportin e BE-së.



# ZKA-ja: Mangësitë në menaxhimin e proceseve të IT-së rrezikojnë integritetin e E-Prokurimit

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit "Sistemi elektronik i prokurimit publik E-Prokurimi" për periudhën 1 janar 2017 - 30 qershor 2023. Rezultatet e auditimit kanë treguar se E-Prokurimi ka ndihmuar në rritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencën e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit publik, mirëpo ka mangësi në proceset e teknologjisë së informacionit që ndikojnë në ruajtjen e vazhdueshme të qëndrueshmërisë dhe integritetit të këtij sistemi. Ky auditim ka vënë në pah se në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) nuk ka ndarje të duhur të detyrave të zyrtarëve të TI-së, prandaj kryerja e detyrave kyçe për funksionimin e sistemit bëhet nga operatorët ekonomikë të jashtëm, duke rrezikuar të krijohet varësi ndaj palëve të



trëta. Po ashtu, KRPP-ja nuk është mjaftueshëm efikase ndaj menaxhimit të problemeve në sistem, për rrjedhojë mund të rrezikojë që t'i zbatojë të gjitha detyrat, përgjegjësitë dhe t'i arrijë objektivat, si dhe rrezikon vazhdimësinë e operimit të këtij sistemi. "Gjithashtu kontrollet hyrëse dhe siguria e E-Prokurimit kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Në modulet e këtij sistemi nuk ishin të vendosura kontrollet apo kufizimet e

nevojshme si dhe ndërlidhjet me sistemet bazë të Republikës së Kosovës, për parandalimin e procedimit të të dhënave të pasakta, e në veçanti të dhënat e përdoruesve. Po ashtu politikat për siguri të informacionit nuk ishin të plota. Llogaritë e pavlefshme nuk identifikoheshin që të pasivizohen, ndërsa fjalëkalimet ndryshohen rrallë nga përdoruesit. Për hapjen e llogarive në këtë sistem janë përdorur email-e privat, madje i

njëti email është përdorur për hapjen e më shumë se një llogarie duke ekspozuar kredencialet e përdoruesve tek personat tjerë", ka njoftuar ZKA-ja, duke bërë me dije se rezultatet e auditimit tregojnë se rreth 50 për qind e përdoruesve nuk u janë përmbajtur kushteve dhe termave për përdorimin e E-Prokurimit si dhe udhëzimeve administrative për llogaritë elektronike zyrtare. "Llogaritë elektronike si dhe aktivitetet që realizoheshin nga këto llogari nuk janë monitoruar nga autoritetet kontraktuese që e kanë obligim mirëmbajtjen e përdoruesve të tyre dhe as nga KRPP-ja si pronare e kësaj platforme. Hapja e panevojshme e llogarive të përdoruesve, mungesa e mbylljes së përdoruesve pasiv si dhe mungesa e monitorimit të llogarive të përdoruesve ndër të tjera dobësojnë punën e platformës së prokurimit elektronik, rrisin rrezikun e

kërcënimeve të sigurisë së informacionit si dhe mundësinë e keqpërdorimit të llogarive për aktivitete jashtë rregullave të prokurimit publik", ka njoftuar ZKA-ja. Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme Vlora Spanca ka vlerësuar se procesi i auditimit ka identifikuar mangësi në menaxhimin e proceseve të teknologjisë së informacionit që ndikojnë në ruajtjen e vazhdueshme të qëndrueshmërisë dhe integritetit të Sistemit elektronik të prokurimit publik E-Prokurimi. Prandaj, Spanca ka rekomanduar forcimin e kontroleve në këtë sistem. Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 13 rekomandime për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik me qëllim të përmirësimit të mbështetjes së vazhdueshme të procesit të prokurimit publik si dhe ruajtjes së integritetit të sistemit E-Prokurimi.

## Shahini: Veprimet e fundit të qeverisë, tendencë për frikësim të bizneseve

PRISHTINË, 3 GUSHT - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, është duke i parë si veprime për t'i frikësuar bizneset me rastin e publikimit të listës së 48 bizneseve e të cilat, sipas autoriteteve, janë regjistruar me emërtime kundërkushtetuese në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK). "Publikimi i 48 kompanive të cilat pretendohet nga Ministria dhe ARBK-ja që janë antikushtetuese është frikësim i shumë bizneseve që nuk e dinë as vetë se si janë regjistruar në kohët e mëhershme, prandaj duhet një studim dhe një hetim për ta parë se vërtet çfarë është antikushtetuese këtu. Antikushtetuese e shoh që vetë zyrtarët e MTI-së së atëhershme dhe të ARBK-së e kanë shkelur Kushtetutën kur kanë lejuar që këto biznese të regjistrohen në

këtë formë. Kemi shumë biznese në grupin prej 48 që janë shqiptarë dhe kanë pasaporta të huaja ku e kanë regjistruar biznesin si investitorë të huaj. Bie fjala me pasaporta të Malit të Zi dhe ky shtet shkruan në dokumente që vërtet është në gjuhën serbo-kroate e që është zyrtare, që nuk e shkel Kushtetutën", ka thënë Shahini për "EO". Ai ka thënë se këto veprime të shtetit tregojnë edhe pakënaqësi ndaj bizneseve dhe investitorëve. "Është lehtë shteti të linçojë dhe të frikësojë biznese, por pikërisht për këtë kemi pakënaqësi të mëdha të bizneseve, të investitorëve dhe një pakënaqësi publike e cila së fundmi është ngritur kundër institucioneve dhe Ministrisë së Tregtisë dhe ARBK-së për mbyllje dhe marrje të licencave të bizneseve. Duhet t'u jepet afat



dhe kohë t'i përmirësojnë", ka thënë ai. Shahini ka përmendur edhe rastin e mediumit "Klan Kosova", për të cilin ka thënë se është dashur t'i jepet kohë ta përmirësojë dokumentacionin. "Nuk duhet qeveria të marrë vendime befasuese dhe të shpejta para afateve ligjore.

Duhet të respektohet secila gjuhë që është zyrtare në Kosovë. Duhet respektuar Kushtetuta, jo vetëm nga pala kërkuuese, por edhe nga pala vendimmarrëse", ka thënë Shahini. Më tutje, Shahini ka ngritur dilema se çfarë do të ndodhë me bizneset serbe, pasi në listën prej

48 bizneseve të shenjëstruara për licencim antikushtetues, figurojnë edhe kompani serbe. Për këta të fundit, Shahini ka thënë se me të drejtë i kërkojnë dokumentet në gjuhën e tyre. "Në këtë drejtim, qeveria e vendit duhet t'u japë afat kohor të gjitha bizneseve që kanë bërë, sipas tyre, shkelje kushtetuese. Ne kemi edhe kompani serbe aty që nuk do ta përmirësojnë sepse e kanë të drejtën e tyre dhe Qeveria e Kosovës nuk guxon t'ua tërheq atyre për shkak se ata e kërkojnë dokumentin në gjuhën e tyre. Prandaj, veprimet e fundit janë frikësim për bizneset, pavarësisht a janë vendore apo të huaja dhe ne do të duhej ta krijojmë klimën më të përshtatshme, më motivuese e më mbështetëse për ekonominë vendëse në mënyrë që të rriten investimet", ka thënë Shahini.

## Avokati i Popullit aprovon ankesën e Sami Mazrekut: Ligji për Tatimin në Pronë duhet të ndryshohet

PRISHTINË, 3 GUSHT - Avokati i Popullit ka aprovuar kërkesën e drejtorit të Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), Sami Mazrekut, kundër Kuvendit të Kosovës për ndryshimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Deri para kohës kur Mazreku ka bërë ankesën në zyrën e Avokatit të Popullit për t'i regjistruar veturat e tyre qytetarët është dashur ta paguajnë tatimin në pronë. Pas ankesës së drejtorit

Mazreku kjo praktikë diskriminuese e komunave të Kosovës më nuk aplikohet fare. "Avokati i Popullit në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit numër 05/L-019 për Avokatin e Popullit ka pranuar ankesë nga z. Sami Mazreku, parashtruar kundër Kuvendit të Kosovës lidhur me miratimin e Ligjit për Tatimin në pronën e paluajtshme", është thënë në vendimin e Avokatit të Popullit. Më tutje, Avokati i Popullit i

ka rekomanduar Ministrisë së Financave ta ndërmarrë nismën legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në mënyrë që neni numër 29 të hiqet në tërësi. Përndryshe, drejtori i BKS-së, Sami Mazreku, që nga fillimi ka deklaruar se kushtëzimi i qytetarëve në pagesën e tatimit në pronë si kusht për ta regjistruar automjetin është antikushtetues.





# Koleksioni i fermanëve turke të Kishës së Deçanit



Faton B. MEHMETAJ

Dokumentet më të rëndësishme për kishën e Deçanit janë **tri versionet e krisobulave të Deçanit**, dorëshkrime në pergamenë që nga viti 1330. Lidhur me dokumentacionin e vjetër në kishën e Deçanit, ishte botuar një monografi për këto krisobula e Pavle Ivi i Milica Grakovi, **De anske hrisovulje**, e botuar në Novi Sad në vitin 1976. Këtu do të përmenden disa dokumente tjera serbe që janë ruajtur në bibliotekën e kësaj kishë deri më sot, mes tjerash 5 libra të shkruar me dorë, dhe afër 50 libra nga autorë të ndryshëm anonim, sa janë ruajtur dikur në bibliotekën e kishës së Deçanit me çka merret veshë se kjo kishë ka qenë e pasur dhe e fortë në kohën e Lazareviqëve dhe Gjuriq Brankoviqit, ku janë shkruar e përkthyer shumë libra origjinale. Në mesin e këtyre dokumenteve të kishës së Deçanit (është edhe një dokument në gjuhën greqishte) që më tepër është i karakterit juridik dhe përmbajnë akte juridike-private për çështjet e brendshme-interne të kishës, pasi që në Mbretërinë Turke administrata zyrtare është

udhëhequr vetëm në gjuhën turke deri në vitet '70-të të shek. XIX, kur u lejua përdorimi i dokumenteve në të dy gjuhët. Më herët, shumë libra në dorëshkrim të manastirit të De anit janë dërguar në Rusi e vende të tjera. Dokumentet tjera të kësaj kishë mund të ndahen në dokumente për të **mbledhur ndihma në popull për kishën**, siç janë **letrat për ndihmat e kishës (pisanija)**, **letrat (parusija)** që kishtarët deçanas u drejtoheshin arhimandritëve, igumenëve, fetarëve, oborrtarëve, haxhinjëve, zejtarëve, lavëtarëve dhe të gjithë të krishterëve pravosllavë që, përmes bartësit të pasurisë, i cili ka me vete Kryqin e Nderit, shkruhet (regjistrohet) në **Proskomidi**, në Listën e përgjithshme, në **Parusi**, sepse manastiri deçanas për shkak të meremetimit të disa pjesëve kishte rënë në borxhe. Prandaj kërkohet ndihmë. Dokumentet tjera të tilla janë: **dokumentet e pasurisë-pronës**, siç janë **defterët, protokollet, librat e të dalave** (shpenzimeve) dhe në fund **diptihet** (kujtime) që paraqesin një grup të veçantë dokumentesh. Për nga forma që kanë, këto dokumente ndryshojnë nga njëra-tjetra. Kështu, bie fjala, letrat e rregulluara si dëshmi për të mbledhur ndihma për kishën në terrenet e kishave të tjera, janë shkruar vetëm në një fletë letre të dimensioneve të mëdha, ndërsa të tjerat kanë formën e broshurave ose edhe të

kodekseve të lidhura me kopertina lëkure. **Dokumentet në fletë letre** janë si leje që arsyetonte personin zyrtar të kishës për t'i mbledhur ndihmat, përshtirjet etj. Janë të shkruara me një kaligrafi të bukur e veçmas Parusija që është edhe më e pasur me zbukurimin e miniaturave. **Grupi i dytë i dokumenteve** të kësaj kishë kanë formën e **fletoreve (broshurave)** dhe të **librave**, pas përdorimit që kanë janë të një natyre shumë interne dhe kanë përdorim praktik (janë teftere, regjistrime të pasurisë, regjistrime të çifçinjëve etj., prandaj janë thjeshtë të punuara dhe pa kurrfarë zbukurimesh). Vlera e këtyre dokumenteve varet nga përmbajtja që e kanë. Pjesa më e madhe e këtyre dokumenteve janë të shek. XIX dhe kanë rëndësi për njohjen e të dhënave për pozitën ekonomike-financiare të manastirit të Deçanit, dhe të popullatës përreth në atë periudhë historike. Gjenden në këto dokumente, përveç të tjerësh, edhe **Tefteri për tokën e Deçanit**; Tefteri për pasurinë (e kishës) në fshatin Deçan; Tefteri për pasurinë e tokës në fshatin Isniq; Regjistri i çifçinjëve të manastirit të Deçanit; Tefteri për tokën në Isniq; Protokolli për tokën Bivolak në Isniq; Protokolli i manastirit të Deçanit; Librat e daljeve (rashoda) shpenzimeve të manastirit të Deçanit, që janë tri të tilla; **Panduks**-lejeqarkullim për mbledhjen e lëmoshave-




Parastos (diptik) arqipeshkve, mitropolitëve serbë dhe kryemurgjve të Deçanit. shek. XVI, DK-360


përshtirjeve në terren; Letra e Stefan Ristiçiqit për Pisanin, po ashtu gjenden edhe dy letra të tilla për Pisanin. Pesë dokumente të këtij manastiri janë **Diptihët** (Pomenik): Pomenik i arhiepiskopëve, mitropolitëve

dhe jeromonahëve serbë të Deçanit; Diptih (pomenik) i protopapëve, prezviterëve, gjanokëve, bojaxhinjve dhe qytetarëve; Diptih (pomenik) i të bashkëngjiturve për ndihmë (Rab dhe Raba); Diptih (pomenik) i arhiepiskopëve dhe jeromonahëve serbë të patrikanës së Pejës si dhe një Diptih (pomenik) i episcopëve deçanas i shek. XIX.

Këto dokumente serbe të kishës së Deçanit, kujtoj, nuk janë trajtuar ndonjëherë nga hulumtues vendas e as të tjerë, pos që i përmend autorja e librit "Riznica e Deçanit" Mirjana Shakota. Këto dokumente janë burimorë dhe kanë rëndësi të madhe për njohjen e brendisë së tyre dhe mund të shërbejnë si burim për njohjen e historisë së trevës së Deçanit me rrethinë. Kur bëhet fjalë për arkivin e Manastirit të Deçanit duhet cekur se një pjesë e arkivit të këtij manastiri në vitin 1981 është bartur në Beograd. Por ka raste kur në disa shkrime tjera të shkruara në pergamenë në shek. XIV, vërtetojnë se zjarri i shkaktuar në kishë nuk është shkak kryesor i humbjes së disa mjeteve të riznicës së Deçanit, sepse dikush nga personeli e ka shfrytëzuar rastin e rënies së zjarrit në manastir për të marrë ato gjëra sigurisht të çmuara. Sidoqoftë këto dokumente, nëse lejohen për ti studiuar dhe interpretuar, janë të rëndësishme për historikun e Deçanit, sidomos gjatë sundimit turk, por u shërbejnë edhe



Dokument osman i vitit 1716 mbi banorët shqiptarë të Deçanit, Lloçanit dhe Carrabregut



Ferman i Mehmedit IV. 1649. DK-211



studiuesve për ta ndriçuar një periudhë disashekullore të historisë së shqiptarëve të kësaj treve e më gjerë. Sidoqoftë dokumentet në dorëshkrim të bibliotekës së kishës së Deçanit duhet vështruar e peshuar me kujdes, pasi që shumica prej tyre janë dhënë me abet (alfabet) cirilik e disa më vonë të shek. XVI e XVII paraqiten me alfabet të përzier, me shkronja greke e ruse, e me një gjuhë të dobët të serbishtes.


Kisha e Deçanit ka një koleksion të pasur të akteve në gjuhën turke. Këto dokumente janë ruajtur në këtë kishë gjatë tërë sundimit të Perandorisë Osmane-turke në këto treva shqiptare. Kanë qenë këto akte zyrtare të domosdoshme për ekzistencën e kësaj kishë, për pasurinë e saj si dhe për dëshminë e të drejtave ekonomike dhe prejardhjen e këtyre të drejtave që nga fillimi i pushtimit nga turqit. Në arkivat e Manastirit të Deçanit, janë ruajtur pos dokumenteve tjera një numër i konsiderueshëm i fermanëve dhe dokumenteve të tjera nga periudha e perandorisë osmane duke përfshirë këtu edhe **burullditë, huxhetat, mureselat, izna** (lejet) e dokumente të tjera që ishin të domosdoshëm për mbijetesën e manastirit, patundshmërive dhe pasurive të tij. Për ti ruajtur këto privilegie Manastiri i Deçanit pranon vasalitetin e Turqisë që zgjati me shekuj. Vasaliteti i Kishës ortodokse serbe fillon menjëherë pas depërtimit turk në Ballkan, me theks të veçantë pas Betejës së Kosovës (1389), kur kisha ortodokse serbe e kishte pranuar zyrtarisht vasalitetin e Sulltanit. Në këtë kohë Kisha ortodokse serbe e ndihmuar edhe nga sulltanët, pashallarët, kadi të

personalitetet e tjera të Perandorisë turke filluan një fushatë të egër dhe mjaft të gjatë për serbizimin e shqiptarëve ortodoksë, dhe konvertimin e shqiptarëve katolikë në ortodoksë. Në këtë kohë shumë feudal lokal serb filluan të lidhin marrëveshje paqeje me Perandorinë osmane. Ndër të parët që lidhi marrëveshje ishte Knjaz Llazari, i cili në shenjë besnikërie ndaj Perandorisë Osmane, Sulltan Pajazitit i jep për grua vajzën e tij Olivera Lazareviqin në vitin 1390, pikërisht kur nënshkruhet kontrata e vasalitetit të Serbisë ndaj Perandorisë Turke. Sipas Konstantin Jeričekut njëri nga historianët më të mëdhenj të Ballkanit, në librin e tij "Histori e Serbisë", shkruan se kur Sulltan Mehmeti i II-të rrethoi Kostandinopojën në pranverën e vitit 1453, despoti serb Gjorgje Brankoviç i dërgoi si ndihmë 1500 ushtarë serb dhe një njësi minorë të Novobërdës për t'i vënë minat poshtë mureve rrethuese të qytetit.

Trupat e Brankoviçit ishin të parat që depërtuan brenda kryeqytetit bizantin në mëngjesin e 29 majit. Në shenjë të mirënjohjes Sulltani i dërgoi Brankoviçit një pjesë të plaçkave të fitores dhe marrjes së qytetit. Në fondin e dokumenteve që janë ruajtur në arkivat e Manastirit të Deçanit janë edhe vendimet e Sulltan Bajazitit II dhe Sulejmanit të Madhërishtëm nga shekulli XVI, deri tek dokumentet e sulltanëve të cilët kanë sunduar deri në fund të shekullit XIX. Vlen të theksohet se kisha e Deçanit siç u tha, ishte e mbrojtur me fermanin e **Sulltan Sulejmanit** (ligjvënësi) të vitit 1539, dërguar kadiut të Pejës me urdhër për ta mbrojtur atë (kishën) nga spahinjtë, të cilët, pa

ligj, kërkojnë prej igumenit të asaj kishë tatime sikur të ishte ai "raje" e jo igumen i kishës. Sulltan Sulejmani ishte i martuar me një grua ruse e quajtur Aleksandra Anastazia e cila edhe babanë e kishte prift ortodoks.

Në këtë periudhë ndikimi serb i përkrahur nga Perandoria Osmane merr hov të madh. Po në këtë periudhë ishte edhe ndikimi i madh i kishës ruse në hapësirat e Ballkanit. Veziri i madh i Perandorisë Otomane, serbi **Mehmet Pashë Sokoloviç** (1506-1579), me urdhër të Sulltanit rindërtoi Patrikanën e Pejës, caktoi të vëllanë Makarie Sokolloviç, peshkop të Patrikanës së Pejës, duke i dëbuar priftërinjtë ortodoksë arbërorë, por edhe ata bizantinë nga manastiret arbërore, sipas marrëveshjes me Sulltanin. Patrikana e Pejës dhe Manastiri i Deçanit me ferman të Sulltanit iu dhanë në administrim priftërinjve sllavë, duke i dëbuar priftërinjtë arbërorë, (megjithëse sllavë (serbë) në Pejë e në Deçan nuk kishte fare në atë kohë). Patrikana e Pejës është shembull tipik kur një kishë e arbërorëve u bë kishë serbe me dekret të sulltanit dhe nën ndikimin e Mehmet Pashë Sokoloviçit, kryevezir turk me prejardhje serbe. Ai ia doli ta bindte Sulltanin për ta pavarësuar Kishën Ortodokse Serbe dhe siç dihet, edhe serbët përfituan nga kjo situatë. Gjithsesi në këtë mes ndërthureshin edhe interesat e Perandorisë Turke e cila punonte dhe kishte bërë plane e platforma të shumta për ti kthyer shqiptarët në myslimanë. Për ta arritur më shpejt këtë qëllim turqit e përdorën edhe ndikimin e Patrikanës së Kostandinopojës që në ato kohëra ishte vasale e Perandorisë Osmane. Pikërisht në këtë kohë priftërinjtë sllavë në marrëveshje me sundimtarët turq nisën t'i terrorizojnë e t'i trajtojnë skllevër duke përfshirë këtu shqiptarët e dy besimeve ata ortodoksë dhe të krishterë. U bënë shumë përpjekje për të shpëtuar pa u konvertuar, por me kalimin e kohës mbeten pak të atillë pa u konvertuar. Ata një herë e kërkuar mbrojtjen e sulltanit, por kur kjo mbrojtje u mungoi, atëherë u konvertuan në myslimanë, ose ikën maleve, në Bjeshkët e Nemuna e vende tjera. Fermanët dhe dokumentet turke që gjenden në arkivat e manastirit të Deçanit paraqesin një pjesë të administratës së Perandorisë Osmane në vendet e Ballkanit



Ferman i Sulltan Sulejmanit që liron nga taksat Kishën e Deçanit. (shkruar në Konstandinopojë në vitin 1539)


Perëndimor e më gjerë në të cilat përfshihen mjaftë ngjarje të rëndësishme të kohës. Një ferman të rëndësishëm që gjendet në Manastirin e Deçanit e shkroi Sulltan Mehmeti i III-të sa ishte në llogarinë e tij në Zemun, në kohën kur luftonte me Austrinë, luftë kjo që zgjati 7 vjet.

**FERMAN I SULLTAN MEHMEDIT III**

Bojë e zezë në letër, me trugë në krye, 21,5x47 cm. Shkruar në Stamboll, në vitin 1601 Signatura DK-202 Dërguar kadiut të Altun-Ilisë\* (\*Altun-Ilia është quajtur teritori i Junikut) Me qenë se edhe më tej te manastiri mbahen panagjyret ku populli dehet, grinden me njëri-tjetrin dhe bëjnë rrëmujë, ndërsa tubohen edhe njerëz jashtë ligjit, të cilët pinë, rrahen e bëjnë zullume, pastaj vijjnë mirallajët e vojvodët dhe e ngarkojnë manastirin me dënim për këtë, duke mos pasur parasysh se manastiri posedon huxhetin e sheriatit. Sulltani kërkon që rasti të hetohet dhe nëse kjo është e vërtetë, të ndërmerren masat më energjike në mënyrë që kjo të pengohet në

të ardhmen, e fajtorët të dënohen. Shkruar në dekadën e parë të ramazanit\* (\*muaji i nëntë i kalendarit islam) të vitit 1009 (6-15. III 1601) në Stamboll. (Në faqen e pasme të dokumentit: serbishte e vjetër, nuk kuptohet).

Për ruajtjen e Manastirit të Deçanit gjatë sundimit osman ka mjaft dokumente, sidomos urdhëresa nga sulltani, nga vezirët e pashallarët e mëdhenj turq, të cilët urdhëronin të mos i bëhej asnjë dëm manastirit. Një goditje tjetër nga Perandoria Osmane në bashkëpunim edhe me elementin serb të kohës ndaj popullit të rajonit të Dukagjinit e më gjerë nisi me valën e dytë të islamizimit dhe të serbizimit të popullatës arbërore të këtyre anëve. Ky plan ishte kurdisur nga Perandoria Osmane, (kuptohet nga përfaqësuesit e saj), dhe serbëve që i përfaqësonte kryeveziri turko-serb, Mehmet Pashë Sokoloviçi. Popullata arbërore e besimit të krishterë organizuan një kryengritje për t'iu kundërvënë terrorit të priftërinjve sllavë e zaptive turq që e mbroinin Patrikanën të uzurpuar, mirëpo për ta shtypur këtë kryengritje ndërhyri garnizoni turk i qytetit të Pejës, duke i vrarë kryengritësit e duke e masakruar popullatën katolike, kurse në anën tjetër u dolën në ndihmë serbëve të deleguar nga Stambolli. Pasi ushtria e garnizonit turk në Pejë e kishte shtypë kryengritjen, një pjesë e popullatës vendase ikën maleve që të mos nënshtrohen, ndërsa një pjesë tjetër pasi iu nënshtroan një terrori të paparë u detyruan të kthehen në fenë islame, kurse shqiptarët ortodoks të ritit bizantin u konvertuan në ortodoksinë serbe. Gjenezja e këtyre veprimeve datonte nga shekulli XIV, kur trojet e arbitit, u pushtuan nga serbët.



Pandahus gjendet në arkivin e Kishës së Deçanit, gjysma e parë e shekullit XIX, DK-350



Ushtria osmane, mbrojtëse e manastireve të Kosovës



# Kina nuk është aq e fuqishme sa mund të mendojë Perëndimi



Presidenti Xi Jinping dëshiron ta projektojë Kinën si një partner të fuqishëm tregtar – ose kundërshtar të rrezikshëm – për pothuajse çdo vend që shpreson të jetë i suksesshëm në shekullin e XXI-të. “Ngritja e Lindjes dhe rënia e Perëndimit” është motoja e tij. Ndërsa rritja kineze ndodhi edhe politikanët perëndimorë nisën të shqetësoheshin se si të përgjigjeshin. Por mes popullit kinez – dhe gjithnjë e më shumë në kancelaritë dhe sallat e këshillit të Evropës – ka filluar të tregohet një histori tjetër. “Marshimi i Pekinit drejt dominimit ekonomik global mund të mos jetë në fund të fundit i pathyeshëm”. Kina pati një rritje të dobët të PBB-së pasi u çlirua me vonesë nga kufizimet pandemike. Tregu i pronave është në krizë dhe papunësia e të rinjve është rritur në nivele të rrezikshme, me një vlerësim që e vendos atë në 50 për qind. Sipërmarrësit jetojnë gjithnjë e më shumë me frikën se çfarë do t’i bëjë shteti bizneseve të

tyre dhe konsumatorët kanë ndaluar së shpenzuar në mënyrën para COVID. Në Shanghai, Londër dhe New York, bizneset kineze dhe të huaja po përballen tani me një skenar të ri: Po sikur ngadalësimi të vijë këtu? “Rreziqet e një krize të madhe ekonomike në Kinë, ose ndoshta më e mundshme e një stanjacioni të afërt në rritjen e qëndrueshme ekonomike, janë në rritje”, thotë, Jacob Kirkegaard, bashkëpunëtor i lartë në Institutin Peterson për Ekonominë Ndërkombëtare. Ajo që ndodh me ekonominë e Kinës ka një rëndësi të madhe për botën. Sipas statistikave të fundit, ekonomia kineze u rrit me ritme të dobëta në tremujorin e dytë të këtij viti. Por, kjo është shumë më të shëndetshme se sa shumica e ekonomive perëndimore. Perspektiva e pasigurt shton dyshimet sesi Pekini do t’i afrohet Perëndimit. Për momentin është ende e paqartë nëse Xi do të ketë një fytyrë më miqësore ose nëse


kohët më të vështira ekonomike do t’i inkurajojnë palët të kërkojnë pika fërkimi me SHBA-të ose Evropën. Edhe drejtuesit e Partisë Komuniste nuk po e fshehin problemin e tyre. Në mbledhjen e tyre vjetore të Byrosë Politike para verës, e cila vendos tonin e punës ekonomike për pjesën e mbetur të vitit, zyrtarët e partisë vlerësuan se ekonomia “po përballlet me vështirësi dhe sfida të reja”. Në Evropë, si dhe në SHBA, qeveritë po rivlerësojnë në mënyrë radikale dobësitë e tyre ekonomike. Pushtimi rus i Ukrainës tronditi qeveritë e BE-së për të rishikuar varësinë e tyre nga zinxhirët e furnizimit të kontrolluar nga regjime potencialisht jomiqësore. Evropa kryesisht është shkëputur nga importet e lëndëve djegëse fosile ruse, por mbetet e varur nga Kina për lëndët e para kritike që përbëjnë komponentët e baterive që do të jenë jetike për tranzicionin e energjisë së gjelbër, ndër fusha të tjera.

Udhëheqësit perëndimorë nga Ursula von der Leyen e BE-së e deri te presidenti i SHBA-ve, Joe Biden, tani flasin në mënyrë rutinore për “çrrezikun” ekonomik nga Kina. Rreziku i lidhjes shumë të ngushtë me ekonominë kineze ka goditur edhe Olaf Scholz, i cili tradicionalisht shihet si kumbari kryesor i Evropës në politikën e Kinës. Pas dyerve të mbyllura në samitin e tetorit të Këshillit Evropian të vitit të kaluar, Scholz ndau frikën e tij për perspektivën e Kinës. Duke folur pak përpara udhëtimit të tij të parë si udhëheqës gjerman në Pekin, ai u tha homologëve të tij të BE-së se “një krizë masive financiare” mund të shkaktohet nëse Pekini nuk arrin të menaxhojë krizën e tij të pronave. Kryeministrja e re e Italisë, Giorgia Meloni, po përgatitet të tërhiqet nga një marrëveshje sipas së cilës Roma ishte pjesë e planit global të infrastrukturës së Xi, nisma “Një brez, një rrugë”.

Dhe qeveria e Emmanuel Macron, presidentit francez, javët e fundit ka marrë një linjë më kritike ndaj Pekinit, veçanërisht në lidhje me qëndrimin e tij ndaj Ukrainës. Në këtë sfond, qeveria e Pekinit tani është e fokusuar në angazhimin me Perëndimin në një mënyrë më pak të ftohtë, edhe kur bëhet fjalë për rivalin e saj kryesor në Washington. Disa zyrtarë amerikanë – nga Sekretari i Shtetit Antony Blinken te Sekretarja e Thesarit Janet Yellen – kanë vizituar Kinën muajt e fundit. Një samit BE-Kinë është gjithashtu në gatishmëri, sipas një diplomati që foli në mënyrë anonime, sepse planet ende nuk janë finalizuar. Xi ka grumbulluar pushtet të madh personal në kulmin e sistemit politik të Kinës. Nëse Xi-conomics funksionon në fund do të varet në një masë të madhe prej tij. | Marrë nga Politico, përkthyer nga Albanian Post



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT  
 PILKINGTON Invert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



# Kosova - Danimarka, bileta e fundit drejt kualifikimeve për 'Eurobasket 2025'



Prishtinë, 3 gusht - Kambeturvetëm një vend në kualifikimet e FIBA "EuroBasket 2025", pasi Bullgaria dhe Sllovakia kanë siguruar biletat e tyre të mërkurën. Bileta finale do të vendoset të shtunën në Prizren, pasi Kosova pret Danimarkën në Grupin H. Të kryesuar nga ylli i tyre Ife Lundberg, danezët kanë fituar të tria ndeshjet e tyre, duke përfshirë edhe ndeshjen kundër Kosovës në shtëpi në Danimarkë 82-75, shkruan faqja e FIBA-s. Danezët kanë tri fitore,

ndërsa Kosova dy fitore e një humbje, me Zvicrën që është eliminuar, pasi ka humbur katër ndeshjet. Tashmë "dardanët" duhet t'i përmbysin danezët në shtëpi. 32 kombëtare do të marrin pjesë në kualifikime dhe 24 vazhdojnë garat në Evropian. "Eurobasket 2025" do të mbahet në Letoni, Qipro, Finlandë dhe Poloni. Danimarka do të kualifikohej me një fitore ose një humbje 6 pikë më pak; Kosova do të kualifikohej me një fitore prej 7

pikësh e më shumë. Lista e shteteve në kualifikueset e FIBA "EuroBasket 2025": Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Britania e Madhe, Greqia, Hungaria, Islanda, Izraeli, Italia, Letonia, Lituania, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Polonia, Portugalia, Serbia, Sllovakia, Slovenia, Spanja, Suedia, Turqia dhe Ukraina.

# Filloi seminari katërditor për gjyqtarët e futbollit

PRISHTINË, 3 GUSHT - Në kuadër të përgatitjeve për edicionin e ri të garave që nis më 12 gusht, Federata e Futbollit e Kosovës e ka organizuar seminarin e përvitshëm katërditor me gjyqtarët e futbollit. Edhe sivjet seminari po mbahet nën përkujdesjen e instruktorit të FIFA-s, Alan Snoddy, derisa atij do t'i asistojë edhe trajneri i fitnessit, Simon Breivik. Në seminar po marrin pjesë 50 gjyqtarë si dhe 13 anëtarë të Komisionit të Gjyqtarëve. Në hapje të tij të pranishmit i përshëndeti Përparim Hasani, kryetar i Komisionit të Gjyqtarëve. Ai e falënderoi instruktorin Alan Snoddy për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në ngritjen e kuadrove të suksesshme të gjyqtarëve kosovarë, të cilët falë përkushtimit dhe punës së mirë po delegohen në vazhdimësi nga UEFA në garat evropiane. Hasani ka thënë se seminaret e këtilla u ndihmojnë gjyqtarëve për t'u



informuar me rregullat e reja dhe për të qenë sa më të suksesshëm gjatë një ndeshje të futbollit. Në seminar do të ligjërohen tema të ndryshme siç janë: ndryshimet e rregullave, incidentet në zonën e penaltisë, integriteti i zyrtarëve të

ndeshjes, menaxhimi i lojës, loja me dorë, VAR-linja e intervenimit etj. Në kuadër të këtij seminari gjyqtarët do t'u nënshtrohen edhe testeve fizike dhe testeve të tjera teknike të cilat do të zhvillohen në stadiumin e KF "Rilindja".

## SHKURT

### Ramadani transferohet te Lecce për 1.2 milion euro

Mbetet vetëm prezantimi zyrtar, por nuk ka dyshime se një tjetër futbollist i kombëtares së Shqipërisë do të jetë pjesë e Serisë A nga ky sezon. Ylber Ramadani i bashkohet "kolonisë" kuqezi në kampionatin italian me skuadrën e Lecces. Pas tratativave të gjata në merkaton e verës, klubi italian ka arritur t'i marrë shërbimet e mesfushorit, që mbylli sezonin e fundit si protagonist në Skoci me skuadrën e Aberdinit. Mediet angleze dhe ato përtej Adriatikut konfirmuan transferimin e Ramadanit, duke zbuluar edhe detajet financiare. Lecce ka paguar 1.2 milion euro për ta blerë përfundimisht kartonin e futbollistit 27 vjeçar, ndërsa Aberdeen do të ruajë 10 % të tij në rast të rishitjes së futbollistit. Ramadani do të firmosë kontratë trevjeçare me klubin verdhekuq dhe do ta bëjë prezantimin zyrtar.

### Andri Stafa përforcon Lirinë

Skuadra e inkuadruar në Superligën e futbollit të Kosovës, Liria e Prizrenit, është përforcuar me një futbollist cilësor. Bëhet fjalë për 21-vjeçarin Andri Stafa i cili ka qenë pjesë e Tiranës dhe Llapit. "Mesfushori ofensiv Andri Stafa nënshkruan me Lirinë. Ish-lojtari i Tiranës dhe Llapit sot iu bashkëngjiti klubit tonë. 21-vjeçari pritet ta plotësojë fuqishëm mesfushën bardhezi", thuhet në njoftimin e klubit prizrenas.

### Lëndohet Nkunku, mundësi e re për Brojën

Në miqësoren e fundit të zhvilluar në Amerikë, Chelsea nuk arriti më shumë se një barazim ndaj Borussia Dortmundit. Por më shumë se rezultati i ndeshjes, ajo që shqetëson më shumë klubin londinez është dëmtimi i Christofer Nkunku. Sulmuesi u dëmtua në minutën e 20 të takimit duke ndier shqetësime në gju. Ende nuk dihet shkalla e dëmtimit të Nkunkut, por me dëmtimin e francezit rriten shanset për më shumë minuta lojë për Armando Brojën. Sulmuesi i kombëtares shqiptare ka lënë pas dëmtimin dhe është gati për trajnerin Pochetino.

### Diant Ramaj i bashkohet Ajaxit

Portieri me prejardhje nga Kosova, Diant Ramaj, i është bashkuar gjigantit holandez Ajax. Ramaj që përfaqëson Gjermaninë në nivelin ndërkombëtar ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare. Ishte Ajaxi që me anë të një komunikate zyrtare konfirmoi transferimin e Ramajt nga Eintracht Frankfurt, një marrëveshje që thuhet se u mbyll për 12 milionë euro. "Ajax, Eintracht Frankfurt dhe Diant Ramaj kanë arritur marrëveshje për transferimin e portierit tek Ajaxi. 21-vjeçari gjerman me prejardhje nga Kosova nënshkroi kontratë deri më 30 qershor 2028". Kjo padyshim është lëvizja më e madhe që Ramaj ka bërë në karrierë, ku tani i mbetet të luftojë për ta fituar vendin në formacionin bazë.



## Sistemi VAR zbarkon zyrtarisht edhe në tenis

NJU-JORK, 3 GUSHT -

Teknologjia do të bëjë një hap të madh edhe në sportin e tenisit. Duke nisur nga grand slam i US Open (28 gusht-10 shtator), do të aplikohet sistemi VAR edhe në sportin e raketës. Edhe pse në këtë sport ekziston një teknologji, i quajtur "syri i fajkoit", tashmë

sistemi do të pësojë një avancim të mëtejshëm. Në grand slam të fundit sezonal do të hyjë "Video Review Technology", që është testuar më herët nga disa turne më të vegjël. Objektivi është ai i reduktimit në maksimum të gabimeve të gjyqtarit kryesor dhe atyre të linjës. Këtë vit ka

pasur mjaft raste të dyshimta që edhe sistemi i "syrit të fajkoit" nuk mund t'i zbulojë. Përmes "Video Review Technology", gjyqtari kryesor do të ketë mundësi t'i rishohë pamjet e dyshimta si, p.sh., për të kuptuar nëse topi ka rënë dy herë në fushë para se të kapet nga tenisti. Ky sistem

nuk do të aplikohet në të gjitha fushat e US Open, por vetëm në 5 prej tyre, ato më të mëdhatë. Në fushat e tjera do të vijojë sistemi i sotëm. Gjithsesi, gjyqtari kryesor tashmë do të jetë një ndihmë e madhe për ta marrë vendimin e duhur në rastet e dyshimta.



## Paraqitje të kënaqshme nga Mehmeti dhe Karabaxhaku në Lojërat Frankofone

PRISHTINË, 3 GUSHT - Alma Mehmeti dhe Fatih Karabaxhaku nën drejtimin e trajnerit Dardan Imami e përfaqësuan Kosovën në Lojërat Frankofone të cilat u mbajtën në Republikën Demokratike të Kongos. Ata garuan nga data 29 korrik deri më 2 gusht dhe gjatë këtyre ditëve ata garuan në tri kategori të ndryshme dhe shënuan disa fitore të rëndësishme. Në kategorinë ekipore Alma dhe Fatihu shënuan një fitore në grup kundër Guineas me rezultat 2-0, ndërsa pësuan humbje nga ekipi nga Tunizia me rezultat 1-2. Në kategorinë çifte të përziera lojtarët tanë shënuan dy fitore, 3-0 kundër Gabonit, dhe me rezultat zyrtar 3-0 kundër Haitit. Ata gjithashtu ishin shumë afër fitores në ndeshjen kundër Mauritius, nga e cila pësuan humbje me rezultat të ngushtë 2:3. Alma dhe Fatihu garuan edhe në kategorinë individuale. Të dy e siguruan fazën eliminatorë pasi shënuan fitore në grupe. Fatih Karabaxhaku i shënoi 3 fitore në grupe. Ai fitoi me rezultat 3-0 kundër lojtarit nga Mauritius, me rezultat zyrtar kundër lojtarit nga Haiti dhe 3-1 kundër lojtarit nga Benini, për të vazhduar në të 16-n e finale. Ai në këtë fazë u ndesh me lojtarin nga Gaboni dhe fitoi me rezultat 3-0. Fatihu në çerekfinale u ndesh me lojtarin nga shteti nikoqir i cili e kishte përkrashjen e publikut



vendas që ndikoi edhe në performancën e lojtarit kosovar. Ndeshja u mbyll me rezultat 3-1 për kongolezin. Në përgjithësi Karabaxhaku i shënoi 7 fitore nga gjithsej 11 paraqitje në 3 kategori. Në anën tjetër, edhe Alma u rendit e para në grup. Ajo ndeshjen e parë e zhvilloi kundër lojtares nga Togo, të cilën e fitoi me rezultat 3-0. E ndeshjen tjetër kundër lojtares nga Gaboni, kundër së cilës fitoi me rezultat 3-0. Në të 16-n e finale ajo u ndesh me lojtaren nga shteti nikoqir dhe fitoi me rezultat 3-1. Alma gjithashtu u eliminua në fazën çerekfinale pasi pësoi humbje e parë individuale në lojërat frankofone nga lojtarja

armene me rezultat 0-3. Në përgjithësi Mehmeti i shënoi 7 fitore nga gjithsej 10 paraqitje në 3 kategori. "Përveç paraqitjes mbresëlënëse të lojtarëve tanë në lojërat frankofone në Kongo, ku shënuan shumë fitore dhe patën mundësi të mira për të kaluar në gjysmëfinale, ata patën shumë intervista nëpër media të ndryshme, siç ishin mediet nga Franca. Urojmë që përfaqësuesja e Seniorëve të Kosovës të ketë paraqitje të mirë edhe në Kampionatin Ballkanik për Senior i cili do të mbahet në fillim të shtatorit në Bullgari", thuhet në njoftimin e Federatës së Pingpongut të Kosovës.

## Hamiltoni: Më jepni makinën e Perezit dhe ia tregoj unë vendin Verstappenit

LONDËR, 3 GUSHT - 10 fitore nga 12 gara të zhvilluara në këtë sezon, plot 195 pikë dallim me vendin e dytë. Janë këto statistikat e Max Verstappenit në këtë sezon, që tregojnë dominimin e holandezit të Red Bullit teksa duket qartë se 25-vjeçari po bën një kampionat më vete. Dy herë kampioni i botës "udhëton" i qetë drejt titullit të tretë radhazi teksa ndjekësit janë larg për ta shqetësuar. Edhe pse një prej atyre do të bënte gjithçka që të prishte këtë moment kaq



special për Verstappenit, fjala është për rivalin më të madh të holandezit Lewis Hamilton. Piloti

britanik shprehet se nëse ai do ta kishte makinën e Sergio Perezit (makina tjetër e Red Bullit), atëherë do ta bënte me "dhimbje koke" Verstappenin. "A do të doja të isha po aq i shpejtë sa Verstappenit? Sigurisht që po. A do ta doja edhe një makinë po aq të shpejtë sa ajo e tij? Normal. Unë po ju them vetëm kaq, nëse do ta kisha makinën e Sergio Perezit atëherë ju siguroj se Verstappenin nuk do të ishte kaq i lumtur", u shpreh Hamiltoni.

## Messi dhuron spektakël në derbi, shënon edhe dy gola

Tri gola në pesë ndeshje, Leo Messi iu desh shumë pak për ta "pushtuar" edhe Amerikën. "Pleshti" vijon të shkëlqejë me Inter Miami duke i dhuruar ekipit nga Florida suksesin në fazën e 1/16 në Kupën e Ligës.

"Topi i Artë" në fuqi ishte protagonist absolut në derbin përballë Orlando Cityt duke realizuar një "dopietë" golash, goditi shtyllën, ndërsa u tregua modest duke mos ekzekutuar penalltinë. Shtatë

minuta lojë i mjaftuan Messit ta kalonte Inter Miamin në avantazh, një kontroll perfekt i topit në zonë dhe një ekzekutim fluturimthi me të majtën, duke zhbllokuar sfidën. Rivalët barazuan shifrat

në minutën e 17, ndërsa me fillimin e pjesës së dytë Martinez nga pika e bardhë e penalltisë rikthehu Inter Miamin sërish në avantazh. Në të 72-n, Messi u shërbye në zonë, këtë herë me të djathtën

fluturimthi, realizoi golin e tretë për Inter Miamin. Tifozët në stadium shijuan një tjetër paraqitje fantastike nga kampioni i botës i cili është përshtatur shumë mirë me ekipin e tij të ri.

### SHKURT

#### Fabregasi: Askush si Mourinho

Cesc Fabregas ka dhënë një intervistë për The Coaches Voice në të cilën ka folur për mendimet e tij të para si trajner. Këtë verë, në fakt, është larguar nga futbolli i luajtur dhe ka pranuar detyrën e trajnerit të Como-s Under 19. Këto kanë qenë fjalët e tij: "Kjo eksperiencë po më ndihmon ta shikoj në një mënyrë ndryshe futbollin. E ka bërë lamtumirën time si futbollit më të thjeshtë nga sa mendoja". Më pas, ish-mesfushori ka folur për trajnerët me të cilët ka punuar gjatë karrierës së tij. Mes Wenger, Guardiola dhe Mourinho: "Wenger më trajtonte si djalin e tij. Ai kishte gjithmonë një plan për ty dhe ishte një lider. Guardiola ishte shumë më ndryshe, më i shkëputur dhe ky qëndrim ka funksionuar për të. Në fund Mou, çfarë mund të them. Me të flisnim çdo ditë dhe më përcillte shumë besim. Ndiheha më i mirë. Ka luajtur me mendjen time në një mënyrë që askush tjetër nuk e kishte bërë më parë, dhe kjo ka nxjerrë më të mirën nga unë. Është i pabesueshëm".

#### Barça refuzon ofertën e huazimit të Neymarit

Barcelona thuhet se ka refuzuar mundësinë për ta marrë Neymarin në huazim si pjesë e marrëveshjes që dërgon Ousmane Dembele në Paris Saint-Germain. Neymar Jr ka kontratë me gjigantin francez deri në verë të vitit 2025. Megjithatë, së fundmi është përfolur për një largim të mundshëm nga "Parc des Princes". Brazili i ishte i lidhur me një rikthim në Barcelonë, por kjo nuk pritet të ndodhë. Sipas raportimeve nga "Goal", katalanasit kanë refuzuar mundësinë e transferimit të Neymarit edhe në formë huazimi. Kështu Neymarit pritet ta vazhdojë karrierën në Ligën 1.

#### Lëndohet Osimheni

Skuadra e Napolit ka mbyllur turin përgatitës pak ditë para nisjes së kampionatit të Serisë A, me një ndeshje përballë skuadrës spanjolle të Gironas. Në këtë përballje mungonte sulmuesi "vrastar" Viktor Osimheni, i cili nuk ishte as në stol, duke surprizuar jo pak tifozët. Mësohet se sulmuesi ka pasuar një dëmtim muskolor, por besohet se nuk do të ketë probleme serioze. Kujtojmë që Osimhen është një nga sulmuesit më të kërkuar në Evropë, por edhe në Arabi. Napoli nuk ka ndërmend ta lëshojë "xhevahirin" pa një shumë të majme që do t'i mbushte mirë arkat e klubit.

#### Ramosi, afër kalimit në Boca Juniors

Sergio Ramos është një lojtar i lirë pas largimit nga Paris Saint-Germain. Për ish-mbrojtësin e Real Madridit ka interes tashmë edhe klubi legjendar i Argjentinës. Siç raporton "TyCSport", Boca Juniors ka shfaqur interesim së fundmi për Sergio Ramosin. Klubi argjentinës thuhet se është gati t'i ofrojë kampionit të Botës me Spanjën një kontratë 18-mujore. Megjithatë, Ramosi nuk e ka vendosur ende ekipin ku do të vazhdojë të ardhmen. Pas një përvojë dyvjeçare me PSG-në, 37-vjeçari tashmë është lojtar i lirë.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Edmond A. Hasani” BI, Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për “Edmond A. Hasani” BI, Stacioni i Karburanteve në Vushtrri

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.09.2023 në ora 11:00 në Shkolla “Ali Kelmendi” rr. Ajet Gerguri - Vushtrri, do të organizohet debat publik nga Kompania “Edmond A. Hasani” BI, Stacioni i Karburanteve në Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Zoom:

Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/85836248083?pwd=IvwuGv5kyeXbpF7M1wIsLYFJCFskbT.1>

Meeting ID: 858 3624 8083


Passcode: 8qh9Q3

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “Edmond A. Hasani” BI, Stacioni i Karburanteve në Vushtrri

<https://mmpfi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnk.komente@rks-gov.net](mailto:vnk.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mirela Shasivari shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë (10) të Gjimnazit “Ahmet Gashi” Prishtinë.

- Antifona Sheqiri shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë (10) të Gjimnazit “Ahmet Gashi” Prishtinë.

- “Prime Group Constructione” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nrb. 810046781.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës

01-Nr. 016-42649

Me date: 02-08-2023

Ne bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe 2, lidhur me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluejtshme Ligji Nr. 03/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/2009), me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 10 dhjetor 2010; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016); bazuar në Vendimin me nr. Prot. 01-Nr-464-18639 të datës 18.03.2021 për shqyrtimin e mëtej të kërkesës së subjektit kërkuar të Drejtorisë për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjenc; bazuar në Vendimin Preliminar për ligjëshmerinë e shpronësimit të paluejtshmëris me nr. prot. 01-Nr-016-32884 datë 23.05.2023, për **ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike** në Suharekë, Kryetari i Komunës së Suharekës, brenda afatit ligjor, merr këtë :

## VENDIM PËRFUNDIMTAR

**I.SHPRONESOHET** palujtshmeria për interes publik për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike e cila gjindët në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72116046-01946-0. Nga sipërfaqja e përgjithshme prej: 1559m<sup>2</sup> shpronësohet pjesa e parcelës me sip. prej: 37m<sup>2</sup> në vendin e quajtur "Gradina/ rruga Sopijës" e evidentuara sipas qertifikatës së pronës në emër të Bajram (Nexhat) Kryeziu 1/3; Rexhep (Nexhat) Kryeziu 1/3; Shaban (Nexhat) Kryeziu 1/3 ZK. Suharekë.

**II. VERTETOHET** se ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës publike në ZK Suharekë është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe se shpronësimi i palujtshmerisë së lartëcekur është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

**III.** Pronarët e palujtshmerisë për pronën e shpronësuar të evidentuar si në pikën I të këtij Vendimi, kompenzohen konform Aktit- vlerësimit të punuar nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së palujtshme në Prishtinë në shumën prej: 90.00€/m<sup>2</sup> (nëntëdhjet euro.€), ndërsa për pronën e përgjithshme të shpronësuar në sip. prej: 37m<sup>2</sup>, kompenzohet në shumën totale prej: **3,330.00 €.** ( tremij e treqind e tridhjet euro.€).

**IV.** Në përputhje me nenin 11 paragrafi 8, nenin 12 dhe nenit 16 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluejtshme Ligji Nr. 03/L-139, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Përfundimtar, dhe pas pagesës së kompenzimit të përcaktuar me këtë vendim, si dhe pas plotsimit të kushteve të parapara me ligj, Drejtoria Për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër në Komunën e Suharekës merr të gjitha veprimet për regjistrimin e pronës në emër të PSH Komuna e Suharekës.

**V.** Vendimi Përfundimtar hynë në fuqi datën e shpalljes në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

### Arsyetim

Subjekti kërkuar-Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjenc në Komunën e Suharekës, me kërkesën nr. 129 të datës 07.03.2021 ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së palujtshme për interes publik dhe për realizimin e projektit për **ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike** si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Subjekti kërkuar, kësaj kerkese ia ka bashkangjitur dokumentacionin e nevojshem i cili parashihet me dispozitat e nenit 8. lidhur me nenin 4. të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës ka ardh në përfundim se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar në dispozitiv të këtij Vendimi është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejt qellim, dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtën private, se pjesa e pronës së palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme.

Organi shpronësues- Kryetari i Komunës ka miraturar kërkesën e subjektit kërkuar për shpronësimin e pronës së paluejtshme për interes publik me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim 01-Nr-464-18639 datë 18.03.2021.

Po ashtu në afatin ligjorë, organi shpronësues ka miraturar Vendimin Preliminar për ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar 01-Nr-016-32884 datë 23.05.2023.

Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, të Vendimit Përfundimtar, Organi shpronësues, këtë Vendim ia dërgon subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të cilët duhet të identifikohen në Vendimin Përfundimtar.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa e subjektit kërkuar për shpronësimin është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzime Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej 30 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes në fuqi të këtij Vendimi. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejt të dorëzojë në Zyrën Ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për Shpronësim).

Vendimi u dërgohet:

Subjektit kërkuar

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit

Kryetari i Komunës  
Bali Muharremaj



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës

01-Nr. 016-42648

Me date: 02-08-2023

Ne bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe 2, lidhur me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluejtshme Ligji Nr. 03/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/2009), me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 10 dhjetor 2010; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016); bazuar në Vendimin me nr. Prot. 01-Nr-464-18639 të datës 18.03.2021 për shqyrtimin e mëtej të kërkesës së subjektit kërkuar të Drejtorisë për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjenc; bazuar në Vendimin Preliminar për ligjëshmerinë e shpronësimit të paluejtshmëris me nr. prot. 01-Nr-016-32885 datë 23.05.2023, për **ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike** në Suharekë, Kryetari i Komunës së Suharekës, brenda afatit ligjor, merr këtë :

## VENDIM PËRFUNDIMTAR

**I.SHPRONESOHET** palujtshmeria për interes publik dhe për ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike e cila gjindët në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72116046-02789-1, në sipërfaqe prej: 50m<sup>2</sup>; dhe në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72116046-02789-6 në sipërfaqe prej: 34m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Gradina/ Straxhinova" e evidentuara sipas qertifikatës së pronës në emër të HALIT (AVDYL) ELSHANI ZK. Suharekë.

Nga sip. e përgjithshme e parcelës kadastrale P-72116046-02789-1 prej 840m<sup>2</sup> shpronësohet pjesa e parcelës me sip. prej 50m<sup>2</sup>.

Nga sip. e përgjithshme e parcelës kadastrale P-72116046-02789-6 prej 350m<sup>2</sup> shpronësohet pjesa e parcelës me sip. prej 34m<sup>2</sup>.

**II. VERTETOHET** se ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës publike në ZK Suharekë është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe se shpronësimi i palujtshmerisë së lartëcekur është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

**III.** Pronari i palujtshmerisë për pronën e shpronësuar të evidentuar si në pikën I të këtij Vendimi, kompenzohet konform Aktit- vlerësimit të punuar nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së palujtshme në Prishtinë, si vijon :

Për pjesën e ngastrës kadastrale P-72116046-02789-1 në sipërfaqe prej: 50m<sup>2</sup> lartësia e qmimit 85.00€/m<sup>2</sup> ( tetdhjet e pes euro.€), ndërsa kompenzimi për vlerën totale në shumën prej: **4,250.00 €.** ( katërmij e dyqind e pesdhjet euro.€).

Për pjesën e ngastrës kadastrale P-72116046-02789-6 në sipërfaqe prej: 34m<sup>2</sup> lartësia e qmimit 50.00€/m<sup>2</sup> ( pesdhjet euro.€), ndërsa kompenzimi për vlerën totale në shumën prej: **1,700.00 €.** ( njëmij e shtatqind euro.€).

**Totali i kompenzimit është vlerësuar 5,950.00€ (pesëmij e nëntqind e pesdhjet euro €)**

**IV.** Në përputhje me nenin 11 paragrafi 8, nenin 12 dhe nenit 16 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluejtshme Ligji Nr. 03/L-139, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Përfundimtar, dhe pas pagesës së kompenzimit të përcaktuar me këtë vendim, si dhe pas plotsimit të kushteve të parapara me ligj,

Drejtoria Për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër në Komunën e Suharekës merr të gjitha veprimet për regjistrimin e pronës në emër të PSH Komuna e Suharekës.

**V.** Vendimi Përfundimtar hynë në fuqi datën e shpalljes në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

### Arsyetim

Subjekti kërkuar-Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjenc në Komunën e Suharekës, me kërkesën nr. 129 të datës 07.03.2021 ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së palujtshme për interes publik dhe për realizimin e projektit për **ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës publike** si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Subjekti kërkuar, kësaj kerkese ia ka bashkangjitur dokumentacionin e nevojshem i cili parashihet me dispozitat e nenit 8. lidhur me nenin 4. të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës ka ardh në përfundim se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar në dispozitiv të këtij Vendimi është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejt qellim, dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtën private, se pjesa e pronës së palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme.

Organi shpronësues- Kryetari i Komunës ka miraturar kërkesën e subjektit kërkuar për shpronësimin e pronës së paluejtshme për interes publik me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim 01-Nr-464-18639 datë 18.03.2021.

Po ashtu në afatin ligjorë, organi shpronësues ka miraturar Vendimin Preliminar për ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar 01-Nr-016-32885 datë 23.05.2023.

Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, të Vendimit Përfundimtar, Organi shpronësues, këtë Vendim ia dërgon subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të cilët duhet të identifikohen në Vendimin Përfundimtar.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa e subjektit kërkuar për shpronësimin është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzime Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej 30 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes në fuqi të këtij Vendimi. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejt të dorëzojë në Zyrën Ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për Shpronësim).

Vendimi u dërgohet:

Subjektit kërkuar

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit

Kryetari i Komunës  
Bali Muharremaj







ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

*(Award in alphabetical order)*

- ★ NRC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A. Paraguay, Quality
- ★ Fábrica de Bebidas Gasosas Salvadoreñas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Firdi Sijak, Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Fuzaris Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Králové Československo s.r.o. Czech Republic, Quality
- ★ Ibi Zotal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Pariza Sales soken Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales